



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.47

2005

15 qershor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9391 datë 12.5.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për programin vjetor të veprimit të fqinjësisë “CARDS 2004””.....	1677
Ligj nr.9392 datë 12.5.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit European, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të Bashkimit European për menaxhimin e krizës në Bosnjë-Hercegovinë (Operacioni “ALTHEA”)”.....	1695
Ligj nr.9393 datë 12.5.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë dhe financiare për projektin e ndërtimit të linjës 400 kV Tiranë-Podgoricë, ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.) dhe Kreditanstalt Fur Wiederaufbau, Frankfurt am Main (KfW), Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Kreditanstalt Fur Wiederaufbau, Frankfurt am Main (KfW), si dhe të Marrëveshjes së arbitrazhit ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.) dhe Kreditanstalt fur Wiederaufbau, Frankfurt am Main (KfW)”.	1699

LIGJ
Nr. 9391, datë 12.5.2005

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË
KOMUNITETEVE EUROPIANE PËR PROGRAMIN VJETOR TË VEPRIMIT TË
FQINJËSISË “CARDS 2004”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për programin vjetor të veprimit të fqinjësisë “CARDS 2004””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4596, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE FINANCIARE

Kushtet speciale

Komuniteti European, këtu e tutje referuar si “Komuniteti”, i përfaqësuar nga Komisioni i Komuniteteve Europiane, këtu e tutje referuar si “Komisioni”, nga njëra anë, dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë, këtu e tutje referuar si “Përfituesi”, nga ana tjetër, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Natyra dhe qëllimi i veprimit

1.1 Komuniteti do të kontribuojë për financimin e programit “Programi vjetor i veprimit i fqinjësisë CARDS 2004” këtu e tutje referuar si “Programi”, i cili është përshkruar në dispozitat teknike dhe administrative në shtojcën II.

1.2 Ky program do të zbatohet në përputhje me Marrëveshjen financiare dhe shtojcat e saj: Kushtet e përgjithshme (Shtojca I) dhe Masat teknike e administrative (Shtojca II).

Neni 2

Kontributi financiar i komunitetit

2.1 Kostoja totale e programit për vendet e Ballkanit është 15 000 000 €.

2.2 Komuniteti merr përsipër financimin e një shume jo më të madhe se 15 000 000 €. Ndarja e kontributit financiar të Komunitetit sipas zërave të buxhetit është përshkruar në buxhetin e përfshirë në dispozitat teknike dhe administrative në shtojcën II.

Komisioni rezervon të drejtën t'i ndryshojë këto shuma dhe t'i rialokojë të gjitha apo pjesë të këtyre fondeve, nëse është e nevojshme, për programe të tjera të fqinjësisë pa ndryshuar këtë Marrëveshje financiare. Në këtë rast, të gjitha vendet përfituese do të informohen për një gjë të tillë.

Neni 3

Kontributi i përfituesit

Aty ku, pjesë e, apo i gjithë kontributi i Përfituesit është i një natyre jofinanciare, rregullat e detajuara do të përcaktohen në një memorandum mirëkuptimi të veçantë në lidhje me çdo program/projekt.

Neni 4

Periudha e zbatimit

Periudha e zbatimit të Marrëveshjes financiare do të fillojë në momentin e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe do të përfundojë, e shumta, në datën 31.12.2011. Kjo periudhë zbatimi do të përfshijë dy faza: një fazë operative të zbatimit, e cila do të fillojë në momentin e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe do të përfundojë në datën 31.12.2009. Nga kjo datë do të fillojë faza e mbylljes, e cila do të përfundojë në fund të periudhës së zbatimit.

Neni 5

Afati për nënshkrimin e kontratave të zbatimit të Marrëveshjes financiare

Kontratat e zbatimit të Marrëveshjes financiare do të nënshkruhen, e shumta, brenda datës 12.8.2007. Ky afat nuk mund të shtyhet. Kjo dispozitë nuk aplikohet për kontratat e auditimit dhe të vlerësimit, të cilat mund të lidhen më vonë.

Neni 6

Adresat

Të gjitha komunikimet në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes financiare, do të jenë të shkruara, do t'i referohen shprehimisht programit dhe do të dërgohen në adresat e mëposhtme:

a) për Komisionin

Komisioni i Komuniteteve Europiane

Zyra Europiane e Ndhmës dhe Bashkëpunimit (L41 4/2)

Z. G. Quince, Drejtor

B-1049 Bruksel, Belgjikë

Fax: +32 2 295 74 82

b) për Përfituesin
Znj. Ermelinda Meksi
Ministër i Integrimit Europian
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri
Fax: +355 4 25 62 67

Neni 7
Shtojcat

7.1 Dokumentet e mëposhtme do t'i bashkëngjiten kësaj Marrëveshjeje dhe do të përbëjnë pjesë integrale të saj:

Shtojca I: Kushtet e përgjithshme

Shtojca II: Dispozitat teknike dhe administrative

7.2 Në rast të një konflikti midis dispozitave të shtojcave dhe atyre të kushteve speciale të Marrëveshjes financiare, dispozitat e kushteve speciale do të kenë përparësi. Në rast të një konflikti midis dispozitave të shtojcës I dhe atyre të shtojcës II, dispozitat e shtojcës I do të kenë përparësi.

Neni 8
Kushte të tjera speciale të zbatueshme për programin

8.1 Kushtet e përgjithshme plotësohen nga dispozitat e mëposhtme:

Duke marrë parasysh faktin se PF-të mund të zbatohen me sukses vetëm nëpërmjet zbatimit të procedurave të harmonizuara dhe nevojën e bashkërendimit të kërkesave procedurale të PHARE CBC (zbatim i decentralizuar), INTERREG (menaxhim i përbashkët) dhe CARDS (i centralizuar), marrëveshjet financiare të firmosura si me vendet PHARE ashtu edhe me vendet CARDS, si edhe vendimet për INTERREG-un do të përmbajnë detyrimin për respektimin e udhëzimeve përkatëse:

Udhëzimet e zbatimit për kufijtë PHARE CBC/Tacis dhe PHARE CBC/CARDS;

Udhëzimet e zbatimit për kufijtë INTERREG/Tacis dhe INTERREG/CARDS.

Neni 9
Hyrja në fuqi e Marrëveshjes financiare

Marrëveshja financiare do të hyjë në fuqi në datën në të cilën ajo do të nënshkruhet nga pala e fundit.

Bërë në dy kopje origjinale në gjuhën angleze, një kopje për Komisionin dhe një kopje për Përfituesin.

PËR KOMISIONIN
Z. G. Quince (firma)
Drejtor
Zyra e Bashkëpunimit EuropeAid

PËR PËRFITUESIN
Znj. Ermelinda Meksi
Ministër i Integrimit Europian

Bruksel, më 17.9.2004

Tiranë, më

SHTOJCA I
KUSHTET E PËRGJITHSHME

TITULLI I
FINANCIMI I PROJEKTIT/PROGRAMIT

Neni 1

Parime të përgjithshme

1.1 Kontributi financiar i Komunitetit do të kufizohet nga shuma e përcaktuar në Marrëveshjen financiare.

1.2 Dhënia e financimit nga Komuniteti do të kushtëzohet nga plotësimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje financiare nga ana e Përfituesit.

Neni 2

Tejkalimi i kostove dhe mbulimi i tyre

2.1 Tejkalmimet individuale të zërave të buxhetit të Marrëveshjes financiare do të trajtohen me anë të rishpërndarjes së fondeve të buxhetit të përgjithshëm, në përputhje me nenin 17 të këtyre kushteve.

2.2 Në qoftë se ekziston një rrezik i tejkalimit të shumës totale të përcaktuar në Marrëveshjen financiare, Komisioni mund ose të zvogëlojë projektin/programin, ose të kërkojë angazhimin e burimeve financiare të Përfituesit apo burime të tjera jokomunitare.

2.3 Në qoftë se projekti/programi nuk mund të zvogëlohet ose në qoftë se tejkalimi nuk mund të mbulohet as nga fondet e Përfituesit apo burime të tjera, Komisioni mund të japë, në mënyrë të jashtëzakonshme, financime komunitare shtesë. Në këtë rast, kostot shtesë do të financohen pa cenuar rregullat dhe procedurat e Komunitetit, duke çelur një kontribut financiar shtesë, i cili do të përcaktohet nga Komisioni.

TITULLI II
ZBATIMI

Neni 3

Kushte të përgjithshme

3.1 Projekti/programi do të zbatohet nga Komisioni duke vepruar për dhe në emër të Përfituesit.

3.2 Komisioni do të përfaqësohet në shtetin e Përfituesit nga kryetari i delegacionit të tij.

Neni 4

Periudha e zbatimit

4.1 Periudha e zbatimit të Marrëveshjes financiare do të fillojë me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe do të përfundojë në datën e përcaktuar në nenin 4 të këtyre kushteve.

4.2 Kjo periudhë zbatimi do të përfshijë dy faza:

- Një fazë operative zbatimi, ku kryhen veprimtaritë kyesore. Kjo fazë do të fillojë me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe do të përfundojë e shumta 24 muaj përpara mbylljes së periudhës së zbatimit.

- Faza e mbylljes gjatë së cilës do të kryhen kontrollet financiare dhe vlerësimi, si dhe do të mbyllen teknikisht dhe financiarisht kontratat për zbatimin e Marrëveshjes financiare. Kjo fazë do të fillojë në datën e përfundimit të fazës operative të zbatimit dhe do të përfundojë e shumta 24 muaj pas kësaj date.

4.2 Kostot që rrjedhin nga aktivitetet kryesore do të jenë të pranueshme për financimin e Komunitetit vetëm në qoftë se ato kanë lindur gjatë fazës operative të zbatimit. Kostot që rrjedhin nga kontrolli financiar përfundimtar, vlerësimi dhe mbyllja e aktiviteteve do të jenë të pranueshme deri në fund të fazës së mbylljes.

4.3 Çdo fond i mbetur nga kontributi i Komunitetit do të fshihet automatikisht gjashtë muaj pas përfundimit të periudhës së zbatimit.

4.4 Në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara siç duhet, mund të paraqitet një kërkesë për zgjatjen e fazës operative të zbatimit dhe, rrjedhimisht, të periudhës së zbatimit. Në qoftë se zgjatja e afatit kërkohet nga Përfituesi, kërkesa duhet të paraqitet të paktën tre muaj përpara përfundimit të fazës operative të zbatimit dhe të miratohet nga Komisioni përpara kësaj date.

4.5 Në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara siç duhet dhe pas përfundimit të fazës operative të zbatimit, mund të paraqitet një kërkesë për zgjatjen e afatit të fazës së mbylljes dhe, rrjedhimisht, të periudhës së zbatimit. Në qoftë se zgjatja e afatit kërkohet nga Përfituesi, kërkesa duhet të paraqitet të paktën tre muaj përpara përfundimit të fazës së mbylljes dhe të miratohet nga Komisioni përpara kësaj date.

TITULLI III LIDHJA E KONTRATAVE DHE DHËNIA E GRANTEVE

Neni 5

Kushte të përgjithshme

Të gjitha kontratat e zbatimit të Marrëveshjes financiare duhet të lidhen në përputhje me procedurat dhe dokumentet standarde të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për zbatimin e operacioneve të jashtme, në fuqi në momentin e nisjes së procedurave në fjalë.

Neni 6

Afati përfundimtar për nënshkrimin e kontratave të zbatimit të Marrëveshjes financiare

6.1 Kontratat e zbatimit të Marrëveshjes financiare duhet të nënshkruhen nga të dyja palët brenda tre vjetësh nga miratimi i angazhimit buxhetor nga Komisioni, e shumta në datën e përcaktuar në nenin 5 të kushteve speciale. Ky afat nuk mund të shtyhet.

6.2 Norma e mësipërme nuk do të aplikohet për kontratat e kontrollit financiar dhe të vlerësimit, të cilat mund të nënshkruhen edhe më vonë.

6.3 Në datën e përmendur në nenin 5 të këtyre kushteve, çdo fond për të cilin nuk është nënshkruar ndonjë kontratë nuk janë nënshkruar, do të fshihet.

6.4 Çdo kontratë për të cilën nuk ka filluar asnjë pagesë brenda tre vjetësh nga nënshkrimi i saj, do të përfundojë automatikisht dhe fondet e saj do të fshihen.

Neni 7

Pranueshmëria

7.1 Pjesëmarrja në ftesat për tendera për kontratat për punime, furnizime ose shërbime është e hapur në kushte të barabarta për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të shteteve anëtare të Komunitetit dhe në përputhje me kushtet specifike të akteve bazë rregulluese të sektorëve të interesuar të bashkëpunimit, për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të vendeve të treta përfituese ose të çdo vendi tjetër të tretë të përcaktuar shprehimisht në këto akte.

7.2 Pjesëmarrja në konkurset për propozime është e hapur në kushte të barabarta për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të shteteve anëtare të Komunitetit dhe në përputhje me kushtet specifike të akteve bazë rregulluese të sektorëve të interesuar të bashkëpunimit, për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të vendeve të treta përfituese ose të çdo vendi tjetër të tretë të përcaktuar shprehimisht në këto akte.

7.3 Në mënyrë të jashtëzakonshme, në raste të justifikuara të miratuara nga Komisioni, mund të vendoset që, në bazën e kushteve specifike të përcaktuara në aktet bazë rregulluese të sektorëve të interesuar të bashkëpunimit, të lejohen shtetasit e vendeve të treta, të ndryshëm nga ata të përcaktuar në paragrafët 1 dhe 2, të marrin pjesë në tenderat për kontrata.

7.4 Mallrat dhe furnizimet e financuara nga Komuniteti dhe të nevojshme për përmbushjen e kontratave të punimeve, furnizimeve dhe shërbimeve, si dhe të procedurave të prokurimit të nisura nga përfituesi i grantit për zbatimin e aktivitetit të financuar, duhet ta kenë origjinën e tyre në vende të pranueshme për të marrë pjesë, siç përcaktohet në tre paragrafët e mësipërm.

7.5 Ky rregull i kombësisë do të aplikohet gjithashtu për ekspertët e propozuar nga ofruesit e shërbimeve, të cilët do të marrin pjesë në procedurat e tenderave ose në kontratat e shërbimeve të financuara nga Komuniteti.

TITULLI IV RREGULLAT E ZBATUESHME PËR PËRMBUSHJEN E KONTRATAVE

Neni 8

E drejta e vendosjes dhe e qëndrimit

8.1 Kur justifikohet nga natyra e kontratës, personat fizikë dhe juridikë që marrin pjesë në ftesat për tendera për kontratat e punimeve, furnizimeve ose shërbimeve do të gëzojnë të drejtën e përkohshme të vendosjes dhe të qëndrimit në vendin e Përfituesit. Kjo e drejtë do të jetë e vlefshme për një muaj pas dhënies së kontratës.

8.2 Kontraktorët (duke përfshirë përfituesin e grantit) dhe personat fizikë, shërbimet e të cilëve janë të nevojshme për përmbushjen e kontratave, si dhe anëtarët e familjeve të tyre do të gëzojnë të drejta të ngjashme gjatë zbatimit të projektit/programit.

Neni 9

Normat tatimore dhe doganore

9.1 Tatimet, detyrimet doganore dhe detyrime të tjera (duke përfshirë TVSH-në ose taksa ekuivalente) do të jenë të përjashtuara nga financimi i Komunitetit.

9.2 Shteti përfitues duhet të aplikojë për kontratat e prokurimeve dhe grantet e financuara nga Komuniteti normat tatimore dhe doganore më të favorizuara, të aplikuara për shtetet ose organizatat e zhvillimit ndërkombëtar me të cilat ai ka marrëdhënie.

9.3 Aty ku marrëveshja kuadër ose shkëmbimi i letrave të aplikueshme përfshin norma më të detajuara mbi këtë çështje, ato duhet të aplikohen gjithashtu.

Neni 10

Normat mbi kursin e këmbimit

10.1 Shteti përfitues merr përsipër të autorizojë importin ose blerjen e valutës së huaj të nevojshme për zbatimin e projektit. Ai merr përsipër gjithashtu të aplikojë normativën e tij kombëtare për këmbimin e valutës në një mënyrë jodiskriminuese për kontraktorët që lejohen të marrin pjesë sipas nenit 7 të këtyre kushteve.

10.2 Aty ku marrëveshja kuadër ose shkëmbimi i letrave të aplikueshme përfshin norma më të detajuara mbi këtë çështje, ato duhet të aplikohen gjithashtu.

Neni 11

Përdorimi i të dhënave nga studimet

Aty ku Marrëveshja financiare përfshin financimin e një studimi, kontrata në lidhje me këtë studim, nënshkruar për zbatimin e Marrëveshjes financiare, duhet të rregullojë pronësinë e këtij

studimi, si dhe të drejtat e Përfituesit ose të Komisionit për të përdorur të dhënat në studim, për ta publikuar atë ose për t'ua dhënë palëve të treta.

Neni 12

Alokimi i fondeve të rikthyera nga kontratat

12.1 Fondet e rikthyera nga pagesat e kryera gabimisht, nga garancitë e pagesave parafinancuese ose nga përfitimet që rrjedhin nga garancitë e ofruara në bazë të kontratave të financuara sipas kësaj Marrëveshjeje financiare, duhet të alokohen për projektin/programin.

12.2 Ndëshkimet financiare të vendosura nga autoriteti kontraktues ndaj një kandidati apo pjesëmarrësi në tender, i cili hyn në rastet e përjashtimit në kuadrin e një kontrate prokurimi, kërkesa për garancitë e tenderit, si dhe dëmet që i shkaktohen Komisionit, do t'i ripaguhen buxhetit të përgjithshëm të Komuniteteve Europiane.

TITULLI V

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 13

Transparenca

13.1 Çdo projekt/program i financuar nga Komuniteti do të jetë objekt i operacioneve të përshtatshme informuese dhe komunikuese. Këto veprime do të përcaktohen me miratimin e Komisionit.

13.2 Këto operacione informuese dhe komunikuese duhet të kryhen sipas rregullave të përcaktuara e të publikuara nga Komisioni për transparencën e aktiviteteve të jashtme, në fuqi në momentin e kryerjes së këtyre veprimeve.

Neni 14

Parandalimi i parregullive, mashtrimit dhe korrupsionit

14.1 Përfituesi duhet të marrë masat e përshtatshme për të parandaluar parregullsitë dhe mashtrimet dhe, me kërkesë të Komisionit, të nisë ndjekjet penale për rikthimin e fondeve të paguara gabimisht. Përfituesi do të informojë Komisionin për çdo masë të marrë.

14.2 "Parregullsi" do të thotë çdo shkelje e Marrëveshjes financiare, kontratave të zbatimit ose të së drejtës komunitare, e cila shkaktohet si pasojë e një veprimi ose mosveprimi të një operatori ekonomik, dhe që ka ose do të kishte si efekt cenimin e buxhetit të përgjithshëm të Komuniteteve Europiane ose të buxheteve të administruara prej tyre, duke pakësuar ose duke humbur të ardhura që rrjedhin nga burime të tyre të mbledhura direkt në emër të Komuniteteve Europiane ose nga çdo zë i pajustificuar shpenzimi.

"Mashtrim" do të thotë çdo veprim ose mosveprim i qëllimshëm që lidhet me:

- përdorimin ose paraqitjen e dokumenteve ose deklarateve të rreme, jokorrekte ose të paplota, të cilat kanë si efekt të tyre përvetësimin ose mbajtjen e padrejtë të fondeve nga buxheti i përgjithshëm i Komuniteteve Europiane ose nga buxhetet e administruara prej tyre ose në emër të tyre;

- mosdhënien e informacionit në kundërshtim me detyrimet specifike, me të njëjtin efekt;

- keqpërdorimin e këtyre fondeve për qëllime të tjera të ndryshme nga ato për të cilat janë ofruar fillimisht.

Përfituesi do të informojë menjëherë Komisionin për çdo element që sillet në vëmendjen e tij, i cili lë për të dyshuar për parregullsi ose mashtrim.

14.3 Përfituesi merr përsipër të ndërmarrë të gjitha masat e duhura për të ndrequr çdo praktikë korruptive pasive ose aktive, çfarëdo qoftë ajo, në çdo fazë të procedurës për dhënien e kontratave ose granteve ose në zbatimin e kontratave që lidhen me të. "Korrupsion pasiv" do të thotë

veprim i paramenduar i një nëpunësi, i cili, direkt ose me anë të një ndërmjetësi, kërkon ose përfiton avantazhe të çdo lloji, çfarëdo qoftë ky, për veten e tij ose për një palë të tretë, ose pranon një premtim për një përfitim të tillë, për të vepruar ose për t'u shmangur nga veprimi në përputhje me detyrën e tij ose në ushtrimin e funksioneve të tij, duke shkelur detyrat e tij funksionale, veprim që ka ose do të kishte si efekt cënimin e interesave financiarë të Komuniteteve Evropiane. "Korrupsion aktiv" do të thotë veprim i paramenduar i cilitdo që, direkt apo nëpërmjet një ndërmjetësi, i premtton ose i jep një avantazh të çdo lloji, çfarëdo qoftë ai, një nëpunësi për veten e tij ose për një palë të tretë, për të vepruar ose për t'u shmangur nga veprimi në përputhje me detyrën e tij ose në ushtrimin e funksioneve të tij, duke shkelur detyrat e tij funksionale, veprim që ka ose do të kishte si efekt cënimin e interesave financiarë të Komuniteteve Evropiane.

Neni 15

Verifikimet dhe kontrollet nga Komisioni, Zyra europiane kundër mashtrimit (OLAF) dhe Gjykata e Kontrollit Financiar e Komuniteteve Evropiane

15.1 Përfituesi bie dakord që Komisioni, OLAF dhe Gjykata e Kontrollit Financiar e Komuniteteve Evropiane të kryejnë kontrolle dokumentacioni apo në vend mbi përdorimin që i është bërë financimit të Komunitetit sipas Marrëveshjes financiare (duke përfshirë procedurat për dhënien e kontratave dhe granteve), si dhe të kryejnë një kontroll financiar të plotë, nëse është e domosdoshme, në bazë të dokumenteve mbështetëse të llogarive dhe dokumenteve kontabël, si dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me financimin e projektit/programit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes si dhe për shtatë vjet pas datës së pagesës së fundit.

15.2 Përfituesi bie dakord gjithashtu që OLAF mund të kryejë kontrolle në vend dhe verifikime në përputhje me procedurat e përcaktuara nga e drejta komunitare për mbrojtjen e interesave financiare të Komuniteteve Evropiane kundër mashtrimit dhe parregullsive të tjera.

15.3 Për këtë qëllim, Përfituesi merr përsipër t'u japë nëpunësve të Komisionit, të OLAF dhe të Gjykatës së Kontrollit Financiar të Komuniteteve Evropiane, si dhe përfaqësuesve të tjerë të autorizuar, mundësinë e hyrjes në vendet dhe ambientet në të cilat aktivitetet e financuara sipas Marrëveshjes financiare janë kryer, duke përfshirë sistemet e tyre kompjuterike, si dhe çdo dokument ose të dhënë të informatizuar, që lidhet me administrimin teknik dhe financiar të këtyre aktiviteteve, si dhe të marrë përsipër çdo masë që është e nevojshme për të lehtësuar punën e tyre. Kjo mundësi hyrjeje për përfaqësuesit e autorizuar të Komisionit Evropian, të OLAF dhe Gjykatës së Kontrollit Financiar të Komuniteteve Evropiane do të jepet në kushtet e një konfidencialiteti të plotë lidhur me palët e treta, duke mos cenuar detyrimet që rrjedhin nga e drejta publike të cilave ato i nënshtrohen. Dokumentet duhet të jenë të konsultueshme dhe të arkivuara në një mënyrë që të lejojë inspektim të lehtë të tyre. Përfituesi është i detyruar të njoftojnë Komisionin, OLAF ose Gjykatën e Kontrollit Financiar të Komuniteteve Evropiane për vendin e saktë ku ruhen këto dokumente.

15.4 Kontrollet dhe kontrollet financiare e përmendura më sipër do të aplikohen edhe për kontraktorët dhe nënkontraktorët, të cilët kanë përfituar financime të Komunitetit.

15.5 Përfituesi do të njoftohet mbi misionet e kontrollit në vend nga përfaqësuesit e emëruar nga Komisioni, OLAF ose Gjykata e Kontrollit Financiar.

Neni 16

Konsultimet midis Komisionit dhe Përfituesit

16.1 Përfituesi dhe Komisioni do të konsultojnë njëri-tjetrin përpara paraqitjes së çdo mosmarrëveshjeje në lidhje me zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje Financiare.

16.2 Konsultimet mund të çojnë në ndryshimin, ndërprerjen ose përfundimin e Marrëveshjes financiare.

Neni 17
Ndryshimet në Marrëveshjen financiare

17.1 Çdo ndryshim për shtojcën II të Marrëveshjes financiare do të bëhet me shkrim dhe do të jetë objekt i një shtojce.

17.2 Në qoftë se kërkesa për një ndryshim vjen nga Përfituesi, ky i fundit duhet t'ia paraqesë kërkesën Komisionit të paktën tre muaj përpara datës së propozuar për hyrjen në fuqi të shtojcës, me përjashtim të rasteve të justifikuara siç duhet nga Përfituesi dhe të pranuar nga Komisioni.

17.3 Rastet specifike të zgjatjes së afatit të fazës operative të zbatimit ose fazës së mbylljes janë të rregulluara nga neni 4 (5) dhe (6) i këtyre kushteve.

Neni 18
Pezullimi i Marrëveshjes financiare

18.1 Marrëveshja financiare mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e Marrëveshjes financiare, në qoftë se Përfituesi shkel detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja financiare.

b) Komisioni mund të pezullojë Marrëveshjen financiare, në qoftë se Përfituesi shkel një detyrim që lidhet me të drejtat e njeriut, parimet demokratike dhe shtetin e së drejtës dhe në rastet serioze të korrupsionit.

c) Marrëveshja financiare mund të pezullohet për shkak të një force madhore, siç përcaktohet më poshtë. "Forcë madhore" do të thotë një situatë e paparashikueshme dhe e jashtëzakonshme ose ngjarje përtej kontrollit të palëve, e cila pengon palët në përmbushjen e çdo detyrimi, dhe që nuk mund t'i ngarkohet një gabimi ose pakujdesie të tyre (ose kontraktorëve të tyre, përfaqësuesve ose punonjësve), si dhe provohet të jetë e pakapërcyeshme, pavarësisht nga përpjekjet që mund të bëhen. Difektet në pajisje ose materiale ose vonesat për t'i bërë të disponueshme, mosmarrëveshjet e punës, grevat ose vështirësitë financiare nuk mund të konsiderohen si forcë madhore. Një palë nuk do të konsiderohet në shkelje të detyrimeve të saj, në qoftë se nuk ka mundur t'i përmbushë ato për shkak të një force madhore. Një palë që ballafaqohet me një forcë madhore duhet të informojë pa vonesë palën tjetër, duke deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikuara të problemit. Gjithashtu ajo duhet të marrë çdo masë për të minimizuar dëmet e mundshme.

18.2 Asnjë njoftim paraprak nuk do të jepet për vendimin e pezullimit.

18.3 Në momentin e njoftimit të pezullimit, do të tregohen edhe pasojat mbi kontratat në fuqi ose kontratat që janë ende për t'u firmosur.

Neni 19
Përfundimi i Marrëveshjes financiare

19.1 Në qoftë se çështjet që shkaktojnë pezullimin e Marrëveshjes financiare, nuk zgjidhen për një periudhë katërmujore, çdo palë mund të mbarojë marrëveshjen financiare me dy muaj paralajmërim.

19.2 Kur një marrëveshje financiare nuk ka fillur ndonjë pagesë brenda tre vjetësh nga nënshkrimi i saj ose kontratat e zbatimit nuk janë firmosur sipas datave të përcaktuara në nenin 5 të këtyre kushteve, atëherë marrëveshja financiare do të mbarojë automatikisht.

19.3 Në momentin e njoftimit të mbarimit, do të tregohen edhe pasojat mbi kontratat në fuqi ose kontratat që janë ende për t'u firmosur.

Rregullat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

20.1 Çdo mosmarrëveshje në lidhje me Marrëveshjen financiare, e cila nuk mund të zgjidhet brenda një periudhe gjashtëmujore nga konsultimet midis palëve sipas nenit 16 të këtyre kushteve, mund të zgjidhet me anën e arbitratit me kërkesën e njëres prej palëve.

20.2 Në këtë rast, secila nga palët do të caktojë një arbitër brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës për arbitrat. Në qoftë se kjo nuk verifikohet, secila nga palët mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitratit (Hagë) të caktojë një arbitër të dytë. Dy arbitrat, nga ana e tyre, do të caktojnë një arbitër të tretë brenda 30 ditëve. Në qoftë se kjo nuk verifikohet, secila nga palët mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitratit të caktojë arbitrin e tretë.

20.3 Përveç rastit kur arbitrat vendosin ndryshe, do të aplikohen procedurat e përcaktuara në rregullat fakultative të arbitrimin për organizatat ndërkombëtare dhe shtetet e Gjykatës së Përhershme të Arbitratit. Vendimi i arbitrave do të merret me shumicë votash brenda një periudhe tremujore.

20.4 Secila palë do të jetë e detyruar të marrë masat e nevojshme për aplikimin e vendimit të arbitrave.

SHTOJCA II

MASAT TEKNIKE DHE ADMINISTRATIVE CARDS 2004 - PROGRAMI I FQINJËSISË

1. Identifikimi

Forma e programit: Shumëvendësh

Titulli: Programi i fqinjësisë CARDS

Viti buxhetor: 2004

Linja e buxhetit: 19 07 01

Alokimi financiar: 15 000 000 €

Baza ligjore: Rregullorja e Këshillit 2666/2000 ndryshuar nga rregullorja e Këshillit (EC) nr. 2415/2001 (CARDS)

Kontraktimi: Të gjitha kontratat duhet të lidhen pas nënshkrimit të Marrëveshjes financiare dhe brenda 36 muajve nga data e angazhimit buxhetor.

Zbatimi: Zbatimi i projekteve të financuara nga ky program do të përfundojë më 31.12.2009. Si pasojë, të gjitha aktivitetet teknike të parashikuara në këtë program dhe të gjitha kontratat duhet të mbarojnë deri më 31.12.2009.

Programimi: Shërbimet e Komisionit, DP RELEX dhe AIDCO

DSR dhe PIR: Dokumenti Strategjik Rajonal CARDS 2004 – 2006 dhe Programi Indikativ 2002 – 2004

Shënim. Deri në 5% të alokimeve të çdo programi fqinjësie mund të përdoret për disa kosto administrative.

2. Përmbledhja e programit

Programi i fqinjësisë (PF) CARDS reflekton direkt objektivat e politikës së komunikimeve të Komisionit mbi një Europë më të gjerë dhe mbi krijimin e një instrumenti të fqinjësisë. Ky komunikim i fundit ofron një vlerësim të mundësive për krijimin e një instrumenti të ri të fqinjësisë. Komisioni propozon një përjasje në dy faza. Faza fillestare 2004 – 2006 do të përqendrohet në përmirësimin e koordinimit midis instrumenteve të ndryshëm financiare dhe legjislacionit e kuadrit financiar ekzistues. Në fazën e dytë, për periudhën e pas vitit 2006, Komisioni synon të propozojë një instrument ligjor të ri duke trajtuar kërkesat e përbashkëta të identifikuara në komunikatën mbi një Europë më të gjerë.

Bazuar në këto orientime, programi i fqinjësisë CARDS synon që në fazën fillestare të trajtojë çështjet që lidhen me çështje të përbashkëta, që rrjedhin nga afërsia gjeografike si zhvillimi ekonomik i zonave kufitare, mjedisi dhe sëmundjet e komunikueshme (ngjitëse), emigracioni i paligjshëm, trafiqet, si edhe kontaktet ndërmjet personave *inter alia*.

Një listë e të gjitha programeve të fqinjësisë (siç paraqitet në komunikimin mbi Instrumentin e Fqinjësisë) jepet në shtojcën 1. Alokimet e propozuara për programin e fqinjësisë për vitin 2004 paraqiten në shtojcën 2 dhe një përmbledhje e zbatimit të angazhimeve jepet në shtojcën 3.

Një total prej 45 000 000 € është caktuar për programet e fqinjësisë në periudhën 2004 – 2006. Është parashikuar të caktohen 15 000 000 € çdo vit. Ndarja specifike për vendet/programet për vitet 2005 dhe 2006 nuk është vendosur ende, por shpërndarja do të jetë e ngjashme si e vitit 2004. Alokimi i plotë për CARDS 2004 PF është 15.000.000 € (shih shtojcën 2).

Të gjitha projektet do të zbatohen në linjë me rregullat e konkurrencës së BE-së (duke përfshirë parimet mbi ndihmën shtetërore).

3. Përditësimi i programit

Programi Indikativ Shumëvjeçar i programit rajonal CARDS trajton tashmë, brenda pjesës “Menaxhimi i integruar i kufijve”, domosdoshmërisë për të siguruar një lidhje logjike dhe plotësim maksimal jo vetëm me programet ndërkufitare dhe ndërkombëtare INTERREG, por gjithashtu dhe me programet PHARE të bashkëpunimit ndërkufitar.

Kjo lidhje logjike dhe ndërthurje maksimale po zyrtarizohen me programet e fqinjësisë që janë në proces të fillimit të zbatimit.

Programet e fqinjësisë mbulojnë të gjitha ato rajone të Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Serbisë dhe Malit të Zi¹ që janë në kufij, ose do të jenë në kufij me vendet e BE-së apo vendet kandidatë. Bashkimi Europian synon të zhvillojë një zonë të përparuar dhe të fqinjësisë së mirë me të cilën Bashkimi Europian të zhvillojë marrëdhënie të ngushta, paqësore dhe bashkëpunimi.

Bashkëpunimi ndërkufitar ndihmon në krijimin e mundësive më të mëdha për popujt në rajonet kufitare dhe një bashkëpunim më i madh rajonal mund të ndihmojë për një zhvillim ekonomik dhe integrim në nivelin bazë, si edhe për rritjen e ndërsjellë të mirëkuptimit dhe forcimin e besimit në dy anët e kufirit. Shumë çështje që lindin nga afërsia do të vazhdojnë të trajtohen në programet kombëtare CARDS. Programet e fqinjësisë do të përqendrohen në ato fusha bashkëpunimi ku pjesëmarrja aktive e përfituesve nga të dy anët e kufirit është thelbësore. Një vijueshmëri logjike dhe e plotë ndërmjet programeve të fqinjësisë dhe programeve kombëtare do të sigurohet në nivelin strategjik të programimit. Programet e fqinjësisë do të mbulojnë një gamë të gjerë veprimesh, si infrastruktura në sektorët e transportit, mjedisit, energjisë, kalimit të kufirit etj.; investimet për kohezionin ekonomik dhe social (investime prodhuese, zhvillimi i burimeve njerëzore, infrastrukturës të lidhur me biznesin, bashkëpunimi për zëvillimin kërkimor shkencor e teknologjik dhe risitë); ndërveprimi midis njerëzve (si p.sh.: shkëmbimet dhe bashkëpunimi kulturor e arsimor); mbështetja për forcimin e institucioneve etj.

Programi i jep një rëndësi të veçantë shtrirjes ndërkufitare të projekteve dhe qëndrueshmërisë së bashkëpunimit. Kësisoj, është e rëndësishme që projektet në program të bashkërendohen me burime financiare të tjera, si INTERREG dhe projektet PHARE CBC, mbi bazën e të cilave janë krijuar programet e fqinjësisë. Mbështetja e projekteve që kanë një lidhje të qartë me projektet INTERREG apo PHARE është një nga përparësitë e programit. Shërbimet e Komisionit, veçanërisht EuropeAid në bashkëpunim të ngushtë me DP RELEX, DP REGIO dhe DP ELARG kanë marrë një sërë masash për të përmirësuar bashkërendimin dhe komunikimin ndërmjet tri instrumenteve financiare. Megjithatë, arrijtjet konkrete në këtë drejtim kanë qenë të kufizuara për shkak të rregulloreve të ndryshme që rregullojnë instrumentet e ndryshme të Komunitetit.

¹ Sipas SCR1244 nga ky alokim mund të përfitojë edhe Kosova.

4. Ndihma e mëparshme e KE-së dhe mësimet e nxjerra

Ky program duhet të përfitojë nga mësimet e nxjerra nga përvoja e mëparshme e zbatimit të bashkëpunimit ndërkuftar. Në veçanti, ai duhet të jetë i thjeshtë për t'u vënë në funksionim dhe duhet të përfshijë të gjithë partnerët përkatës në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor në mënyrë që të krijojë një pronësi të plotë të të gjithë përftuesve që kanë lidhje me programin.

Programi CARDS i menaxhimit të integruar të kufijve përfshin një element i cili mbulon bashkëpunimin kufitar rajonal. Janë ndërmarrë disa projekte përgatitore në këtë fushë, dhe mësimet e përftuara nga këto projekte do të merren parasysh. Për shembull, Kroacia ka qenë pjesëmarrëse aktive të dy programeve-nisma të Komunitetit për bashkëpunimin ndër-Adriatik ndërmjet Italisë dhe vendeve CARDS dhe në bashkëpunimin tripalësh me Slloveninë dhe Hungarinë. Programet përcaktojnë përparësitë e zhvillimit dhe kriteret që duhen të plotësojnë projektet në kufijtë e jashtëm të BE-së.

Përsa i takon bashkëpunimit kufitar rajonal ndërmjet vendeve të programit CARDS, ka pasur disa nisma të përzgjedhura në nivel vendor. Megjithatë, organizimi dhe zbatimi zyrtar i bashkëpunimit ndërkuftar në të gjitha nivelet administrative duket sikur ende ka nevojë për përforsim. Në këtë drejtim, brenda programit rajonal CARDS 2003 është parashikuar një "Program për forcimin e institucioneve ndërkuftare" në të kuadrin e të cilit do të krijohen struktura dhe programe të përbashkëta, si edhe do të identifikohen përparësitë për bashkëpunim ndërmjet vendeve të programit CARDS. Ky projekt përfshin gjithashtu edhe një skemë grant për aktivitete të nivelit vendor ndërmjet rajoneve fqinje të vendeve të programit CARDS.

Duke marrë parasysh të gjitha aktivitetet e ndërmarrë deri tani, dhe me synimin për të filluar zbatimin e nisur programit aktual, është e domosdoshme të vazhdohet me forcimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet duke mundësuar kështu një pjesëmarrje të shëndoshë në programet e bashkëpunimit ndërkuftar.

Mësimet duhet të nxirren edhe nga eksperiencat e programeve TACIS CBC, PHARE CBC dhe INTERREG.

5. Komponentët e programit

Në 11 mars 2003, Komisioni, me anë të komunikimit mbi një Europë më të gjerë (fqinjësia), shpalli politikën europiane të fqinjësisë. Kjo politikë synon të shfrytëzojë mundësitë dhe të trajtojë sfidat për marrëdhëniet e zgjeruara të Bashkimit European me fqinjët e tij lindorë dhe jugorë, si dhe të zhvillojë një politikë fqinjësie koherente, edhe pse të diferencuar. Në këtë kontekst, në korrik 2003 u nxorr një komunikim i dytë, i cili mbulon ofrimin e mbështetjes për aspektet e bashkëpunimit ndërkuftar dhe ndërkombëtar të kësaj politike, e quajtur "Krijimi i një instrument të ri të fqinjësisë".

Ky komunikim parashikon krijimin e një instrumenti të ri të fqinjësisë për të nxitur kështu bashkëpunimin ndërkuftar përgjatë kufijve të jashtëm të BE-së së zgjeruar. Por, duke marrë parasysh një sërë problemesh juridike dhe buxhetore që duhen zgjidhur, komunikimi paraqet një përjasje me dy faza:

1. Për periudhën 2004-2006 do të prezantohen programet e fqinjësisë, bazuar në bashkërendimin e përmirësuar të instrumenteve ekzistuese;
2. Pas vitit 2006 do të krijohet një instrument i ri i fqinjësisë.

Ky plan veprimi mbulon kuotën e parë të financimit për programet e fqinjësisë 2004-2006 për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Për momentin bashkëpunimi në kufijtë e jashtëm të tanishëm dhe të ardhshëm të Bashkimit European mbështetet nga një sërë instrumentesh. Instrumentat e BE-së që nxisin bashkëpunimin ndërkuftar dhe atë nënrajonal/ndërkombëtar që kanë lidhje me këtë program, janë:

Nisma e Komunitetit INTERREG², një instrument financiar në kuadrin e Fondeve Strukturore të Bashkimit Europian, mbështet bashkëpunimin ndërkufitar, ndërkombëtar dhe ndërrajonal ndërmjet vendeve anëtare dhe vendeve fqinje. Megjithëse programet INTERREG përfshijnë në mënyrë direkte vendet fqinje, fondet strukturore mund të përdoren vetëm brenda Bashkimit Europian. Kështu, programet INTERREG në kufijtë e jashtëm të Bashkimit Europian kërkojnë burime financiare për aktivitete që zhvillohen brenda vendit fqinjë.

Në kuadrin e instrumentit të paraanëtarësimit PHARE për vendet kandidate, programet PHARE CBC³ mbështesin bashkëpunimin ndërkufitar me vendet anëtare dhe ndërmjet vendeve kandidate. Deri më tani, bashkëpunimi ndërkufitar për kufijtë e jashtëm të vendeve kandidate është financuar nëpërmjet programeve kombëtare PHARE. Për periudhën 2004-2006, shtrirja gjeografike e programeve PHARE CBC do të zgjerohet në mënyrë që të mbulojë kufijtë e jashtëm të Bullgarisë dhe të Rumanisë.

Në vendet e Ballkanit Perëndimor, programi CARDS është një instrument kyç i procesit të Stabilizim-Asocimit, dhe në këtë aspekt ai mbështet një sërë aktivitete. Rregullorja e programit CARDS identifikon ndër të tjera qëllimin për nxitjen e bashkëpunimit rajonal, ndërkombëtar, ndërkufitar dhe ndërrajonal të vendeve përftuese, ndërmjet tyre dhe Bashkimit Europian, si dhe ndërmjet vendeve përftuese dhe vendeve të tjera të rajonit.

Këto instrumente rregullohen nga rregulloret të ndryshme dhe si të tilla ato veprojnë me procedura të ndryshme të identifikimit, përzgjedhjes dhe zbatimit të projekteve, duke e bërë të vështirë zbatimin e projekteve me të vërtetë të përbashkëta (d.m.th., ato projekte që i shërbejnë të njëjtit objektiv dhe që veprojnë në të dy anët e kufirit në të njëjtën kohë). Kuadri dhe procedurat ligjore aktuale për këtë bashkëpunim kanë qenë efektive në mënyrën e tyre. Megjithatë, ato kanë krijuar një sërë vështirësish që lindin nga sisteme thelbësisht të ndryshme që zbatohen për menaxhimin financiar të fondeve të Komunitetit, duke nënkuptuar kështu role dhe përgjegjësi të ndryshme për Komisionin dhe autoritetet kombëtare, rajonale e vendore. Ndryshimet konsistojnë veçanërisht në mospërputhjen e niveleve të financimit, në procesin e programimit (procese të veçanta programimi), në përzgjedhjen e projekteve (procese të veçanta vlerësimi dhe përzgjedhjeje, si dhe procedura të ndryshme vendimore) dhe monitorimin e projekteve (procedura të ndryshme raportimi, monitorimi dhe vlerësimi), të cilat kufizojnë ndikimin e bashkëpunimit përgjatë kufijve të jashtëm. Me qëllim nxitjen e një bashkëpunimi më të mirë, Komisioni ka përcaktuar direktiva të brendshme për harmonizimin e këtyre instrumenteve.

Objektivat dhe qëllimi i programeve të veçanta të fqinjësisë (PF) përcaktohen bashkërisht nga vendet pjesëmarrëse. Komisioni miraton programin e veçantë të fqinjësisë duke ndjekur procedurën normale përkatëse për INTERREG (dhe për programet PHARE CBC në rastet përkatëse). Kështu, aprovimi që Komisioni i jep PF-së përcakton qëllimin dhe objektivat si për financimin e brendshëm e të jashtëm, ashtu edhe për miratimin e fondit të brendshëm. Gjithashtu, Komisioni miraton elementin e financimit të jashtëm, në përputhje me procedurën standarde për financimin e jashtëm. Komisioni nënshkruan një marrëveshje financimi me secilin nga partnerët e jashtëm që vendosin padyshim lidhjen ndërmjet financimit të jashtëm dhe PF-së, aprovuar sipas rregullave normale të programit INTERREG.

Fondi i projektit të fqinjësisë të programit CARDS është instrumenti përmes të cilit financimi i programit CARDS u sigurohet 9 programeve dypalëshe të fqinjësisë, programeve CADSES dhe Itali-Adriatiku.

Zonat gjeografikisht të pranueshme

² Rregullorja e Këshillit (CE) Nr 1260/1999, datë 26 qershor 1999 dhe Direktivat INTERREG III, OJ C143, datë 23 maj 2000.

³ Rregullorja e Komisionit (CE) Nr 2760/98, datë 18 dhjetor 1998.

Programet e fqinjësisë do të operojnë në kufijtë e jashtëm të Bashkimit European të zgjeruar, duke përfshirë kufijtë e Rumanisë dhe Bullgarisë me vendet e Ballkanit Perëndimor.

Territori i plotë i vendeve përfutuese të programit CARDS: Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Serbia e Mali i Zi (përfshirë edhe Kosovën sipas Rezolutës 1244 të KB-së) konsiderohet i pranueshëm për programin e fqinjësisë në përgjithësi. Megjithatë, secili program fqinjësie që përfshin këto vende do të përcaktojë zonën e tij të pranueshme specifike.

Veprime të pranueshme

Secili program fqinjësie përcakton përparësitë, që do të jenë në përputhje me një nga katër objektivat e mëposhtëm, të përcaktuara në komunikimin për instrumentin e ri të fqinjësisë:

- nxitja e zhvillimit ekonomik e social të qëndrueshëm në rajonet kufitare;
- puna e përbashkët për të trajtuar sfidat e përbashkëta në fusha, si: mjedisi, shëndeti publik dhe parandalimi e lufta kundër krimit të organizuar;
- sigurimi efikas i kufijve;
- nxitja e veprimeve vendore të tipit “popull-me-popull”.

Procedurat e zbatimit

Një element i rëndësishëm i këtyre programeve është se ato do të veprojnë si me financimin e brendshëm të BE-së ashtu edhe me atë të jashtëm, nëpërmjet procedurave të harmonizuara për aq sa qe e mundur (për më shumë informacion, shih shtojcën 3). Shkurtimisht, këto programe përfshijnë:

- programimin e përbashkët të masave;
- krijimin e një procesi të vetëm aplikimi;
- një thirrje e vetme për propozime në të dy anët e kufirit;
- proces të përbashkët përzgjedhjeje për projektet.

Ato do të menaxhohen, për aq sa është e mundur, nga vendet pjesëmarrëse në veprim të përbashkët në strukturat e përbashkëta të menaxhimit, duke respektuar – për sa u takon kontributeve të programit CARDS – kërkesat zyrtare të menaxhimit, të përcaktuara si në rregulloren financiare ashtu edhe në rregulloren e programit CARDS.

Në mënyrë që procesi i përzgjedhjes të zhvillohet duke mbuluar si financimin e brendshëm ashtu edhe atë të jashtëm, Komiteti i seleksionimit do të përcaktohet dhe do të funksionojë në përputhje me dispozitat që kanë lidhje me menaxhimin e përbashkët për financimin e brendshëm, dhe mbi bazat e menaxhimit të decentralizuar për financimin e jashtëm. Praktikisht, kjo nënkupton se anëtarët e Komitetit të seleksionimit nga shtetet anëtare do të emërohen në përputhje me rregullat standarde të fondeve strukturore. Anëtarët e Komitetit të seleksionimit nga vendet partnere do të emërohen nga Njësia Kombëtare e Koordinimit në vendin përkatës.

Decentralizimi i krijimit dhe funksionimit të Komitetit të seleksionimit për financimin e jashtëm mund të justifikohet duke marrë parasysh natyrën e përbashkët të PF-së, madhësisë së kufizuar të projekteve individuale për financim dhe përfshirjen e ngushtë të vendeve anëtare në zbatim. Përbërja e Komitetit të seleksionimit dhe përzgjedhja e projekteve që do të financohen – në bazë të nenit 164 të rregullores financiare – është e decentralizuar drejt autoriteteve të vendit përkatës.

Komiteti i përbashkët i seleksionimit është përgjegjës për zgjedhjen e projekteve në secilin program fqinjësie. Ai përmbush rolin e “Komitetit të vlerësimit” të përshkruar në PRAG.

Anëtarët e Komitetit të përbashkët të seleksionimit vijnë nga secili vend pjesëmarrës në programin e fqinjësisë. Numri i anëtarëve për çdo vend caktohet me marrëveshje ndërmjet vendeve të përfshira. Secili vend emëron anëtarët e tij.

E rëndësishme për t'u theksuar është fakti se, përderisa metoda bazë që përdoret për përzgjedhjen e projekteve është thirrja për propozime, ky propozim financiar nuk përfshin paketën e zakonshme të fishave të projekteve të CARDS, që tregojnë ndarjen e shpenzimeve të propozuara. Në vend të kësaj, në shtojcën 2 përcaktohet ndarja e alokimeve të propozuara për financim për çdo program fqinjësie.

Gjithashtu, janë në proces analize edhe mënyrat për financimin e masave për forcimin e kapaciteteve, të cilat do të jenë thelbësore për rritjen e kapaciteteve të autoriteteve rajonale dhe vendore në vendet partnere të programit CARDS, në mënyrë që të përfitojnë sa më shumë nga mundësitë e paraqitura nga programet e fqinjësisë.

Objektivi kryesor do të jetë forcimi i kapaciteteve të autoriteteve vendore dhe rajonale si edhe e përfutësve të tjerë social-ekonomik në rajonet që e gëzojnë këtë të drejtë, për sa i përket menaxhimit të projekteve. Në veçanti, ajo do të përpiket të vërë në zbatim një sërë projektesh të zhvillimit ndërkufitar, duke ndihmuar përfutësit përfundimtarë të përgatisin aplikime të mira projektesh për mbështetje në kuadrin e programeve të fqinjësisë.

Programet e fqinjësisë 2004-2006 do të hapin rrugën për një instrument të ri fqinjësie (IRF), me rregulloren e vet përkatëse, që do të zbatohet pas vitit 2006. Ky instrument i ri, që tani është duke u përpunuar, do të sigurojë fonde për aktivitete ndërkufitare në të dy anët e kufirit të ardhshëm të BE-së. Ka të ngjarë që ai të veprojë duke u bazuar në një përjasje programesh shumëvjeçare, të zbatohet nga një mekanizëm i përbashkët menaxhimi si në vendet anëtare ashtu edhe në vendet partnere, si dhe të ketë një buxhet më të madh. IRF-ja do të ngrihet mbi ekspertizën dhe strukturat e krijuara në kontekstin e programeve të fqinjësisë.

6. Ndihmë plotësuese e KE-së jashtë këtij program veprimi

Ky propozim financiar duhet të plotësojë dhe të jetë koherent me të tjera politika dhe instrumente përkatëse të BE-së, duke përfshirë programet kombëtare të ndihmës financiare, si edhe politikat e instrumentet e veçanta sektoriale.

Gjithashtu, programi CARDS po ndërmerr një numër masash plotësuese në kufijtë e jashtëm të Bashkimit Europian nëpërmjet programeve kombëtare të veprimit CARDS.

7. Bashkërendimi me donatorë të tjerë

Koordinimi i donatorëve, për sa i takon elementit të jashtëm, do të sigurohet nga delegacionet e KE-së dhe Agjencisë Europiane për Rindërtim.

8. Zbatimi i programit

8.1 Afati për firmosjen e Marrëveshjes financiare

Marrëveshja financiare duhet të firmoset, e shumta, brenda 31 dhjetorit të vitit që vjen pas vitit në të cilin angazhimi i përgjithshëm financiar përkatës është miratuar. Në rast të kundërt, fondet e caktuara do të anulohen.

8.2 Periudha e veprimit

a) Periudha e zbatimit të Marrëveshjes financiare fillon me hyrjen në fuqi të marrëveshjes financiare dhe përfundon më 31.12.2011.

b) Kjo periudhë veprimi ndahet në dy faza të veçanta:

i) Zbatimi operativ i aktiviteteve kryesore. Kjo fazë fillon me hyrjen në fuqi të marrëveshjes financiare dhe përfundon në datë 31.12.2009;

ii) Faza e mbylljes gjatë së cilës do të kryhen kontrollet financiare dhe vlerësimet e kontratave për zbatimin e Marrëveshjes financiare. Kjo fazë fillon me përfundimin e fazës së zbatimit operativ dhe përfundon në fund të periudhës së veprimit.

c) Shpenzimet e kryera për aktivitetet kryesore nuk janë të pranueshme për financimin e Komunitetit, veç nëse janë kryer gjatë fazës së zbatimit operativ. Shpenzimet e nevojshme për kontrollet financiare përfundimtare e vlerësimin, si dhe aktivitetet e mbylljes janë të pranueshme deri në fund të fazës së mbylljes.

d) Çdo fond i mbetur nga kontributi i Komunitetit do të anulohet automatikisht gjashtë muaj pas përfundimit të periudhës së veprimit.

8.3 Procedurat për dhënien e kontratave dhe të subvencioneve

Të gjitha kontratat zbatuese të Marrëveshjes financiare duhet të jepen duke përdorur procedurat standarde të Komisionit dhe dokumentet për zbatimin e operacioneve të jashtme që janë në fuqi në momentin e fillimit të procedurës.

8.4 Kontratat zbatuese të Marrëveshjes

a) Kontratat zbatuese të Marrëveshjes financiare duhet të firmosen nga të dyja palët brenda tre viteve nga miratimi nga ana e Komisionit të angazhimit financiar. Ky afat nuk mund të shtyhet. Në këtë datë të gjitha fondet e pakontraktuara do të anulohen.

b) Çdo kontratë që nuk ka sjellë asnjë pagesë brenda tre viteve nga firmosja e saj do të përfundohet automatikisht dhe fondet do të anulohen.

8.5 Monitorimi, vlerësimi dhe auditimet

Gjatë zbatimit do të kryhen monitorimet e planifikuara e të rregullta të duhura në formën e raporteve të rregullta. Do të kryhet gjithashtu edhe vlerësimi gjatë zbatimit dhe në përfundim të programit, si dhe auditimi i programit. Pika 8.4 (a) nuk do të aplikohet për auditimet dhe vlerësimet e kontratave, të cilat mund të firmosen më vonë.

8.6 Kostot administrative

Të gjitha kostot administrative do të financohen nga mekanizmat e financimit të brendshëm të BE-së në rastet kur është ligjërisht e mundur.

Megjithatë, deri në 5% e fondeve të programit të fqinjësisë mund të përdoren për kostot administrative, të cilat mund të kontraktohen nëpërmjet seksioneve të operacioneve të delegacionit. Kjo mund të përfshijë krijimin dhe funksionimin e zyrave të degëve të Sekretariateve të Përbashkëta Teknike në pjesën e jashtme të kufirit.

Llojet e kostove që mund të marren parasysh përfshijnë:

- kostot e stafit të zyrës së degës;
- shpenzimet e udhëtimit për pjesëmarrje në komitetet e monitorimit dhe seleksionimit;
- shpenzimet e udhëtimit për pjesëmarrjen në takimet e ndryshme të PF-së;
- kostot administrative.

Fondet do të menaxhohen nga secili Sekretariat i Përbashkët Teknik i programit të fqinjësisë, nën mbikëqyrjen e delegacioneve përkatëse.

9. Kostot dhe financimi

Programet e fqinjësisë do të financohen nga një fond grant prej 15 000 000 € dhënë nga Komuniteti, fond ky që do të ndahet si më poshtë ndërmjet veprimeve të ndryshme. Referojuni shtojcës 2 për një ndarje të detajuar.

10. Angazhimet e qeverisë/kushtëzimet

Ndihma ofrohet mbi bazën e ekzistencës së elementeve të nevojshme për vazhdimin e bashkëpunimit nëpërmjet ndihmës, në veçanti respektimi i parimeve demokratike dhe i të drejtave të njeriut. Dhënia e ndihmës kushtëzohet nga nënshkrimi dhe respektimi nga ana e qeverive përfituese i kushteve të ndihmës CARDS, siç është përcaktuar në Marrëveshjen financiare dhe shtojcat e saj dhe në dokumente të tjera përkatëse, si marrëveshjet kuadër.

SHTOJCA 1

LISTA E PROGRAMEVE TË FQINJËSISË

Programi i fqinjësisë	Vendet e përfshira
Veri (Kolarctic)	Fin, S, N, Rus
Karelia	Fin, Rus
Finlanda Juglindore / Rusi	Fin, Rus
Estoni / Letoni / Rusi	EE, LV, Rus
Letoni / Lituani / Bjellorusi	LV, LT, Bel
Lituani / Poloni / Rusi	LT, PL, Rus
Poloni / Ukrainë / Bjellorusi	PL, UKR, Bel
Hungari / Sllovaki / Ukrainë	Hun, SLK, UKR
*Slloveni / Hungari / Kroaci ⁴	SLN, Hun, HR
*Hungari / Rumani / Serbi Mal i Zi ⁵	HUN, Rom, SeM
*Itali / Adriatiku	I, HR, BiH, SM, ALB
*Itali / Shqipëri	I, ALB
*Greqi / Shqipëri	GR, ALB
*Greqi / IRJM	GR, FYROM
Spanjë / Marok	E, MAR
Gjibraltari / Marok	UK, MAR
Rumani/ Ukrainë	Rom, UKR
Rumani / Moldavi	Rom, MOL
*Bullgari / Serbi & Mal i Zi	Bul, SeM
*Bullgari / IRJM	Bul, FYROM
Deti Balltik	D, DK, FIN, EE, LV, LT, PL, N, Rus, Bel
*CADSES	D, A, I, GR, CZ, SLK, SLN, PL, HUN, ROM, BUL, HR, SeM, BiH, FYROM, ALB, UKR, MOL
Mesdheu perëndimor	I, F, E, P, UK, GR, Mal, (MAR, ALG, TUN)
Archimed	GR, I, Mal, Cyp, (TUR, EGY, ISR, LEB, SYR, Pal, Jor)

Lista e programeve është vetëm indikative dhe bazohet në programet INTERREG për vendet anëtare aktuale dhe të ardhshme dhe në programet PHARE CBC në kufijtë e jashtëm të Bashkimit Europian të zgjeruar.

Fondi për projektet CARDS të fqinjësisë do të mbështesë ato programe të fqinjësisë që përfshijnë vende të Ballkanit Perëndimor (të shënuara me*).

⁴ Dy PF: Kroaci-Slloveni dhe Kroaci-Hungari

⁵ Dy PF: Hungari-Serbi & Mali i Zi dhe Rumani-Serbi & Mali i Zi (ELARG & REGIO)

SHTOJCA 2
NDARJA E FONDIT TË TË GJITHË PROJEKTIT TË FQINJËSISË PËR VITIN 2004

Programi sipas vendeve	AL	BH	KR	IRJM	SMZ	Totali
CADSES	√	√	√	√	√	1.6
IT/Adriatiku	√	√	√		√	2
IT/Shqipëri	1					1
GR/IRJM				1.8		1.8
GR/Shqipëri	2.2					2.2
Hu/SMZ					1	1
BG/SMZ					1	1
BG/IRJM				1		1
RUSMZ					1.4	1.4
SI/HU/KR			√			2
Totali						15*

IT: Italia
 BH: Bosnjë-Hercegovina
 IRJM: Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
 GR: Greqia
 Hu: Hungaria
 SCG: Serbia dhe Mali i Zi
 BG: Bullgaria
 RU: Rumania
 SI: Sllovenia
 KR: Kroacia

SHTOJCA 3
PËRMBLEDHJE E RREGULLAVE TË ZBATIMIT

Kjo përmbledhje jep informacion mbi rregullat që kanë të bëjnë me zbatimin e programeve të fqinjësisë, dhe në veçanti mbi elementet e financimit të programit CARDS.

Në komunikimin e tij “Krijimi i një instrumenti të ri fqinjësie” të datës 1 korrik 2003⁶, Komisioni vendosi të paraqesë një program fqinjësie për periudhën 2004-2006, si një hap i parë drejt një instrumenti të ri fqinjësie (nga viti 2007).

* Alokime të ngjashme parashikohen për vitet 2005 dhe 2006

⁶ COM (2003) 393 (përfundimtar) i datës 1 korrik 2003

Komunikimi theksoi në mënyrë të qartë se objektivi kyç i programeve të fqinjësisë duhet të jetë përqendrimi mbi progresin ekzistues të bërë në bashkërendimin e instrumenteve ekzistuese të brendshme dhe të jashtme, dhe përbushja e angazhimeve dhe detyrimeve ekzistuese që kanë të bëjnë me periudhën e tanishme të programimit deri në fund të vitit 2006. Ana praktike qëndron në faktin se programet e fqinjësisë për periudhën 2004-2006 do të financohen nga financime të brendshme dhe të jashtme, në përputhje me bazat ligjore, rregulloret financiare, si edhe vendimet përkatëse të Komisionit ekzistues.

Komunikimi theksoi se këto programe të fqinjësisë duhet të lejojnë një proces të vetëm aplikimi, duke përfshirë një thirrje të vetme për propozime që mbulon të dy anët e kufirit, dhe që do të ketë një proces të përbashkët përzgjedhjeje të projekteve.

Komisioni është përpjekur të harmonizojë procedurat si të financimeve të brendshme ashtu edhe të jashtme, në mënyrë që të realizohet një funksionim efektiv i programeve të fqinjësisë për periudhën 2004-2006, duke qëndruar në të njëjtën kohë brenda kushtëzimeve të kuadrit ligjor përkatës ekzistues.

Secili program fqinjësie do të veprojë nën të njëjtën strukturë menaxhuese. Vendet fqinje do të kenë një rol të barabartë në programin e fqinjësisë. Një autoritet përkatës do të emërohet në nivel kombëtar. Do të përfshihet gjithashtu një partneritet i gjerë në nivel rajonal, vendor dhe joqeveritar siç është dhe rasti i pozitës së vendeve anëtare aktualisht.

Secili program fqinjësie do të ketë dy komitete: një Komitet monitorues, i cili do të sigurojë një politikë dhe monitorim financiar të veprimit të programit, dhe një Komitet seleksionues (apo drejtues), i cili do të jetë përgjegjës për përzgjedhjen e projekteve. Një program fqinjësie mund të vendosë të veprojë me një komitet të vetëm që përbush kështu të dyja funksionet. Në rrethana të caktuara, një program mund të ketë më shumë se një komitet të përbashkët seleksionimi (kjo mund të ndodhë në ato raste kur në programin e fqinjësisë janë të përfshira më shumë se dy vende).

Komitetet e secilit program fqinjësie do të kenë një anëtarësi të baraspeshuar të të gjitha vendeve pjesëmarrëse dhe një përfaqësim të përshtatshëm në komision. Secili nga vendet pjesëmarrëse është përgjegjëse për emërimin e përfaqësuesve të tij në komitete. Rregullat për sa i takon anëtarësisë në komitete do të rregullohen për secilin program fqinjësie.

Çdo program fqinjësie do të ketë një Autoritet Menaxhues (organi përgjegjës sipas rregulloreve të fondeve strukturore) për elementin e brendshëm (apo një agjenci zbatuese) në rast të programeve të fqinjësisë me vendet e programit PHARE (Rumania dhe Bullgaria). Për financimin e jashtëm do të ketë dy organe të rëndësishme. Vendet partnere do të caktojnë secili një Njësi të Koordinimit të Programit, që në shumicën e rasteve ka të ngjarë të jetë i njëjti organ që luan rolin e Koordinatorit Kombëtar Ekzistues. Megjithatë, roli i Autoritetit Kontraktues për elementin e jashtëm do të përbushet nga delegacionet e Komisionit ose nga Agjencia Europiane për Rindërtim, në rast të një menaxhimi të centralizuar. Komisioni/AER-ja mund t'ia delegojnë funksionet e autoritetit kontraktues dhe të autoritetit pagues një organi të përshtatshëm, siç përcaktohet nga vendi partner. Në rastin e menaxhimit të decentralizuar, funksionet do t'i caktohen një organi të përshtatshëm, siç përcaktohet nga vendi partner.

Autoriteti Menaxhues dhe Njësia e Koordinimit të Programit duhet të bien dakord për një Sekretariat të Përbashkët Teknik, që do të jetë përgjegjës për rregullat administrative të programit. Shumica e detyrave administrative do të kryhen nga Sekretariati i Përbashkët Teknik, me vendndodhje brenda kufirit që do të përfshijë staf edhe nga vendet fqinje. Sekretariati Teknik i Përbashkët do të jetë përgjegjës për marrjen e aplikimeve për projekte, dhënien e vlerësimit fillestar dhe dhënien e rekomandimeve Komitetit të seleksionimit të projekteve.

Sekretariati i Përbashkët Teknik do të japë gjithashtu këshilla për partnerë të mundshëm projektësh, si dhe do të merret me detyrat e përditshme të menaxhimit që kanë të bëjnë me programin me shpjegimet e duhura për rolet dhe përgjegjësitë e Autoritetit Menaxhues brenda kufirit dhe të Autoritetit Kontraktues jashtë kufirit.

Duke qenë se disa detyra do të kryhen nga Sekretariati i Përbashkët Teknik që mbulon financimin e jashtëm, këto detyra mund të përfshijnë vetëm mbështetje teknike dhe/ose administrative. Nuk mund të ketë transferim të detyrave të autoritetit publik që kanë të bëjnë me menaxhimin e financimit të jashtëm nga Komisioni te vendet anëtare të përfshira dhe/ose Sekretariatit të Përbashkët Teknik.

Po të kemi parasysh faktin se Komisioni do të funksionojë si autoritet kontraktues për elementet e jashtme të këtyre programeve, Komisioni do të vazhdojë të ketë të drejtën të marrë pjesë si vëzhgues në të gjitha takimet e Komitetit drejtues/seleksionues (dhe si këshilltar për Komitetin monitorues).

Financimi i FEZHR-së mund të përdoret për financimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të akomodimit të partnerëve të vendeve fqinje gjatë ndjekjes së programit dhe takimeve për projekte në Bashkimin Europian. Financimi i FEZHR-së mund të përdoret gjithashtu për punësimin e shtetasve të vendeve fqinje në sekretariatet e programeve.

Programet e fqinjësisë do të veprojnë mbi bazën e një procesi aplikimi të vetëm dhe një procesi të vetëm përzgjedhës që mbulon të dyja anët e kufirit. Do të përdoret një format i vetëm aplikimi për çdo projekt, por me një ndarje të qartë të punës për t'u bërë brenda dhe jashtë Bashkimit Europian.

Projektet do të zgjidhen normalisht me anë të propozimeve, ndonëse projekte të veçanta mund të propozohen nga Komiteti monitorues nëpërmjet një procedure të përshtatshme. Komiteti monitorues do të vendosë mbi thirrjen për propozime dhe do të japë autorizimin për publikim me anë të Sekretarit të Përbashkët Teknik.

Aplikimet do t'i dorëzohen direkt Sekretariatit të Përbashkët Teknik, i cili do të bëjë vlerësimin fillestar të secilit projekt, si dhe do të përgatisë rekomandimet për Komitetin seleksionues. Aplikimet do të përfshijnë partnerë si brenda ashtu edhe jashtë Bashkimit Europian. Në raste të veçanta, projektet mund të kenë partnerë vetëm nga një vend me kusht që projekti të ketë një efekt të dukshëm ndërkuftar.

Komiteti i seleksionimit, duke përfshirë anëtarë nga të gjitha vendet pjesëmarrëse, me Komisionin si vëzhgues, do të përzgjedhë projektet që do të financohen.

Vendimi zyrtar për projektin do të jetë i ndryshëm për elementet e brendshme dhe ato të jashtme të projektit duke marrë parasysh rregullat e ndryshme për dhënien e fondeve:

- Pjesë e kufirit brenda BE-së:

Për vendet brenda BE-së, Autoriteti Menaxhues i programit të fqinjësisë do të lëshojë një letër donacioni duke çelur financimin e FEZHR-së për projektin sipas rregullave të fondeve strukturore. Letra e donacionit duhet të lëshohet normalisht brenda 3 muajve nga vendimi i Komitetit të seleksionimit.

- Pjesa e kufirit jashtë BE-së:

Shërbimet përkatëse të Komisionit do të konfirmojnë zyrtarisht vendimin e Komitetit të seleksionimit, dhe mbi këtë bazë Autoriteti Kontraktues do të lidhë kontratën me partnerin(ët) jashtë kufirit të BE-së. Në çdo rast, Komisioni gëzon të drejtën e aprovimit përfundimtar të projekteve. Shpjegime të arsyetuara do të jepen në rast se rrethana të caktuara sjellin refuzimin e një propozimi. Kontrata duhet të lidhet normalisht brenda 3 muajve nga vendimi i Komitetit të seleksionimit.

Autoriteti Menaxhues për programin e fqinjësisë do të japë letra donacioni për partnerin kryesor që ndodhet brenda kufirit të Bashkimit Europian, ndërsa Autoriteti Kontraktues do t'i lëshojë një kontratë partnerit kryesor në zonën fqinje të kufirit. Autoriteti Kontraktues për ndihmën e jashtme do të jetë Komisioni, i cili vepron me anë të delegacioneve të tij apo të Agjencisë Europiane për Rindërtim.

LIGJ
Nr. 9392, datë 12.5.2005

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE BASHKIMIT EUROPIAN, PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
NË OPERACIONIN USHTARAK TË BASHKIMIT EUROPIAN PËR MENAXHIMIN E
KRIZËS NË BOSNJË-HERCEGOVINË (OPERACIONI “ALTHEA”)**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të Bashkimit Europian për menaxhimin e krizës në Bosnjë-Hercegovinë (Operacioni “ALTHEA””, bërë në Bruksel më 7 mars 2005.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4597, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

**NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EUROPIAN,
PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK TË
BASHKIMIT EUROPIAN PËR MENAXHIMIN E KRIZAVE, NË BOSNJË-HERCEGOVINË
(OPERACIONI ALTHEA)**

Bashkimi Europian (BE) dhe Republika e Shqipërisë, më poshtë të quajtuara “Palë”, duke pasur parasysh:

- Miratimin nga Këshilli i Bashkimit Europian të veprimit të përbashkët 2004/570/CFSP të 12 korrikut 2004 për operacionin ushtarak të BE-së në Bosnjë-Hercegovinë;
- Ftesën drejtuar Republikës së Shqipërisë për të marrë pjesë në operacionet e drejtuara nga BE;
- Përfundimin e suksesshëm të procesit të përtëritjes së forcës dhe rekomandimet e komandantit të operacionit të BE-së dhe Komitetit Ushtarak të BE-së për pranimin e pjesëmarrjes së forcave të Republikës së Shqipërisë në operacionet e BE-së;
- Vendimin e Komitetit të Politikës dhe Sigurisë numër BiH/3/2004, datë 29 shtator 2004, për krijimin e komitetit të kontribuesve në operacionin ushtarak të BE-së në Bosnjë-Hercegovinë;

- Vendimin e Komitetit të Politikës dhe Sigurisë numër BiH/5/2004, që ka ndryshuar vendimin BiH/1/2004, për pranimin e kontributit të shteteve të treta në operacionin ushtarak të Bashkimit Europian në Bosnjë-Hercegovinë dhe vendimin BiH/3/2004 për krijimin e komitetit të kontribuesve për operacionin ushtarak të Bashkimit Europian në Bosnjë-Hercegovinë;
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Pjesëmarrja në operacion

1. Republika e Shqipërisë do të marrë përsipër detyrimet përkatëse sipas veprimit të përbashkët 2004/570/CFSP të 12 korrikut 2004 për operacionin ushtarak të BE-së në Bosnjë-Hercegovinë dhe çdo vendimi ose veprimi të përbashkët me të cilin Këshilli i BE-së vendos të zgjerojë operacionin ushtarak të BE-së për menaxhimin e krizës, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe çdo marrëveshje zbatuese.

2. Kontributi i Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të BE-së për menaxhimin e krizës nuk do të ndikojë në pavarësinë vendimmarrëse të BE-së.

3. Republika e Shqipërisë do të sigurojë që forcat dhe personeli pjesëmarrës në operacionin ushtarak të BE për menaxhimin e krizës, marrin përsipër misionin e tyre në përputhje me:

- veprimin e përbashkët 2004/570/CFSP, me amendamentet e mundshme që pasojnë;
- planin e operacionit;
- masat zbatuese.

4. Forca dhe personeli ndihmës në operacion nga Republika e Shqipërisë do të përmbushë detyrat dhe do ketë parasysh vetëm interesin e operacionit ushtarak të BE-së për menaxhimin e krizës.

5. Republika e Shqipërisë do të informojë komandantin e operacionit të BE-së në kohën e duhur për çdo ndryshim të pjesëmarrjes së saj në operacion.

Neni 2

Statusi i forcës

1. Statusi i forcës dhe personelit nga Republika e Shqipërisë që kontribuon në operacionin ushtarak të BE-së për menaxhimin e krizës do të rregullohet nga dispozitat e statusit të forcës të rëna dakord nga BE-ja dhe vendi pritës, nëse ka të tilla.

2. Statusi i forcës dhe personelit që kontribuon në shtabet dhe elementet e komandës të vendosur jashtë Bosnjë-Hercegovinës, do të rregullohet nga marrëveshjet mes shtabeve dhe elementeve të komandave dhe Republikës së Shqipërisë.

3. Pa cenuar dispozitat e statusit të forcës të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, Republika e Shqipërisë do të ushtrojë juridiksion mbi forcat dhe personelin e saj që merr pjesë në operacionin ushtarak të BE-së për menaxhimin e krizës.

4. Republika e Shqipërisë do të jetë përgjegjëse për t'iu përgjigjur çdo ankese lidhur me pjesëmarrjen në operacionin ushtarak të BE-së për menaxhimin e krizës, që rrjedhin ose lidhen me personelin dhe forcën e saj.

Republika e Shqipërisë do të jetë përgjegjëse për të ndërmarrë çdo masë, veçanërisht ligjore dhe disiplinore, kundër forcave të personelit të saj, në përputhje me ligjet dhe rregullat e saj.

5. Republika e Shqipërisë merr përsipër të bëjë një deklaratë për sa i përket heqjes dorë nga ankesat kundër një shteti pjesëmarrës në operacionin ushtarak të BE-së për menaxhimin e krizës, dhe ta bëjë këtë me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje.

6. Bashkimi Europian merr përsipër të sigurojë që shtetet anëtare të bëjnë një deklaratë për sa i përket heqjes dorë nga ankesat, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të BE-së për menaxhimin e krizës, dhe ta bëjnë këtë me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3
Informacioni i klasifikuar

1. Republika e Shqipërisë do të marrë masat e duhura për të siguruar që informacioni i klasifikuar i BE-së të mbrohet në përputhje me rregullat e sigurisë të Këshillit të BE-së të përfshira në vendimin e Këshillit nr.2001/264/EC të 19 marsit 2001 dhe në përputhje me direktivat e tjera të lëshuara nga autoritetet kompetente, përfshirë edhe komandantin e operacionit të BE-së.

2. Nëse BE dhe Republika e Shqipërisë kanë përfunduar një marrëveshje për procedurat e sigurisë për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen në kontekstin e operacionit ushtarak të BE-së për menaxhimin e krizës.

Neni 4
Zinxhiri i komandimit

1. Të gjitha forcat dhe personeli pjesëmarrës në operacionin ushtarak të BE-së për menaxhimin e krizës do të mbeten në komandën e plotë të autoriteteve të tyre kombëtare.

2. Autoritetet kombëtare do t'i transferojnë komandën operacionale dhe taktike dhe/ose kontrollin e forcave dhe personelit, komandantit të operacionit të BE-së. Komandanti i operacionit të BE-së ka të drejtë të delegojë autoritetin e tij.

3. Në menaxhimin e përditshëm të operacionit, Republika e Shqipërisë do të ketë të njëjtat të drejta dhe detyrime si shtetet anëtare të BE-së që marrin pjesë në të.

4. Komandanti i operacionit të BE-së mund, që pas konsultimit me Republikën e Shqipërisë në çdo kohë, të kërkojë tërheqjen e kontributit të Republikës së Shqipërisë.

5. Një përfaqësues ushtarak do të emërohet nga Republika e Shqipërisë për të përfaqësuar kontingjentin kombëtar në operacionin ushtarak të BE-së për menaxhimin e krizës. Përfaqësuesi ushtarak do të konsultohet me komandantin e operacionit të BE-së për të gjitha problemet që lidhen me operacionin dhe do të jetë përgjegjës për disiplinën ditore të kontingjentit.

Neni 5
Aspektet financiare

1. Republika e Shqipërisë do të marrë përsipër të gjitha shpenzimet që lidhen me pjesëmarrjen në operacion, përveçse kur këto shpenzime janë subjekt i financimit të përbashkët, siç sigurohet në instrumentet ligjore në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, si dhe në vendimin e Këshillit 2004/197/CFSP të 23 shkurtit 2004 që vendos të administrojë financimin e shpenzimeve të përbashkëta të operacioneve të BE-së që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe çështjet ushtarake.

2. Në rast vdekjeje, plagosjeje, humbjeje ose dëmtimi të personave fizikë ose juridikë të shtetit(ve) në të cilin kryhet operacioni, Republika e Shqipërisë, kur është vërtetuar përgjegjësia e saj, do të dëmshpërblejë, sipas kushteve të parashikuara në dispozitat për statusin e forcave, nëse ka, sipas përcaktimit në nenin 2(1) të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6
Angazhime për zbatimin e Marrëveshjes

Çdo mase teknike dhe administrative e nevojshme gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, do të arrihet ndërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Bashkimit Europian/ përfaqësuesve të lartë për politikën e jashtme e të sigurisë së përbashkët dhe autoriteteve respektive të Republikës së Shqipërisë.

Neni 7
Mospërputhjet

Nëse ndonjëra nga palët nuk do të përmbushë detyrimet e saj, të përcaktuara në dispozitat e mëparshme të kësaj Marrëveshjeje, pala tjetër do të ketë të drejtën të përfundojë këtë Marrëveshje duke njoftuar një muaj përpara.

Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen nga palët përmes kanaleve diplomatike.

Neni 9
Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas së cilës palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për përmbushjen e procedurave të brendshme respektive për këtë qëllim.
 2. Kjo Marrëveshje do të zbatohet përkohësisht që nga data e nënshkrimit.
 3. Kjo Marrëveshje do të qëndrojë në fuqi për gjithë kohën që Republika e Shqipërisë kontribuon në këtë operacion.
- Bërë në Bruksel, më 7 mars 2005, në katër kopje në gjuhën angleze.

DEKLARATAT

Referuar në nenin 2 (5) dhe (6) të Marrëveshjes

Deklarata e shteteve anëtare të BE-së:

“Shtetet anëtare të BE-së duke zbatuar veprimin e përbashkët të Bashkimit Europian të 2004/570/CFSP të 12 korrikut 2004 për operacionin ushtarak të Bashkimit Europian në Bosnjë-Hercegovinë do të përpiqen, për aq kohë sa dhe sistemi i tyre i brendshëm ligjor e lejon, të heqin dorë për sa është e mundur nga ankesat kundër Republikës së Shqipërisë për plagosjen, vdekjen e personelit të tyre ose dëmtimet apo humbjet e çdo aseti pronë të tyre dhe e përdorur në operacionin e BE-së për menaxhimin e krizës, në rast se këto plagosje, vdekje, dëmtime apo humbje:

- janë shkaktuar nga personeli i Republikës së Shqipërisë gjatë kryerjes të detyrës së tyre në lidhje me operacionin e BE-së për menaxhimin e krizës, përveç rasteve të neglizhencës së madhe ose të veprimeve të pahijshme të kryera me dashje; ose

- rezultojnë nga përdorimi i çdo aseti pronë e Republikës së Shqipërisë, duke siguruar që këto asete janë përdorur në lidhje me operacionin e BE-së për menaxhimin e krizës, përveç rasteve të neglizhencës së madhe ose të veprimeve të pahijshme të kryera me dashje nga personeli i Republikës së Shqipërisë që i ka përdorur këto asete.”

Deklarata e Republikës së Shqipërisë:

“Republika e Shqipërisë duke zbatuar veprimin e përbashkët të Bashkimit Europian të 2004/570/CFSP të 12 korrikut 2004 për operacionin ushtarak të Bashkimit Europian në Bosnjë-Hercegovinë do të përpiqet, për aq kohë sa sistemi i brendshëm ligjor e lejon, të heqë dorë për sa është e mundur nga ankesat kundër çdo shteti pjesëmarrës në operacionin e BE-së për menaxhimin e krizës, për plagosjen, vdekjen e personelit të saj, dëmtimet apo humbjet e çdo aseti prone të saj, e përdorur në operacionin e BE-së për menaxhimin e krizës, në rast se këto plagosje, vdekje, dëmtime apo humbje:

- janë shkaktuar nga personeli gjatë kryerjes të detyrës së tyre në lidhje me operacionin e BE-së për menaxhimin e krizës, përveç rasteve të neglizhencës së madhe ose të veprimeve të pahijshme të kryera me dashje; ose

- rezultojnë nga përdorimi i çdo aseti pronë e shteteve pjesëmarrëse në operacionin e BE-së për menaxhimin e krizës, duke siguruar që këto asete janë përdorur në lidhje me operacionin e BE-së për menaxhimin e krizës, përveç rasteve të neglizhencës së madhe ose të veprimeve të pahijshme të kryera me dashje nga personeli që i ka përdorur këto asete.”

LIGJ

Nr. 9393, datë 12.5.2005

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË DHE FINANCIARE PËR
PROJEKTIN E NDËRTIMIT TË LINJËS 400 KV TIRANË-PODGORICË, NDËRMJET
KORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE (KESH, SHA) DHE
KREDITANSTALT FUR WIEDERAUFBAU, FRANKFURT AM MAIN (KFW),
MARRËVESHJES SË GARANCISË NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KREDITANSTALT FUR WIEDERAUFBAU,
FRANKFURT AM MAIN (KFW), SI DHE TË MARRËVESHJES SË ARBITRAZHIT
NDËRMJET KORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE (KESH, SHA) DHE
KREDITANSTALT FUR WIEDERAUFBAU, FRANKFURT AM MAIN (KFW)”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë dhe financiare për projektin e ndërtimit të linjës 400 kV Tiranë-Podgoricë, ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH, sha) dhe Kreditanstalt Fur Wiederaufbau, Frankfurt am Main (KfW), marrëveshja e garancisë ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Kreditanstalt Fur Wiederaufbau, Frankfurt am Main (KfW), si dhe marrëveshja e arbitrazhit ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH, sha) dhe Kreditanstalt Fur Wiederaufbau, Frankfurt am Main (KfW)”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4598, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE HUAJE DHE FINANCIARE
NDËRMJET KFW, FRANKFURT AM MAIN (KFW) DHE KORPORATA
ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE SHA, TIRANË, SHQIPËRI (KESH) PËR SHUMËN
DERI NË 43 900 000 EURO PËR FINANCIMIN E LINJËS TRANSMETUESE 400 KV
TIRANË-PODGORICË

Bazuar në Marrëveshjen që është ende për t'u konkluduar ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për bashkëpunimin financiar ("Marrëveshje qeveritare"), KESH dhe KfW, këtu më poshtë, hyjnë në huanë e mëposhtme dhe në Marrëveshjen financiare ("Marrëveshje").

KfW është e përgatitur të financojë prokurimin e materialeve dhe të shërbimeve për ndërtimin e linjës së transmetimit 400 kV Tiranë-Podgoricë duke i dhënë KESH-it një financim të kombinuar që konsiston në një kontribut financiar dhe një hua koncesionale të garantuar nga Republika e Gjermanisë të përfaqësuar nga Ministria e Bashkëpunimit dhe e Zhvillimit dhe e shoqëruar nga një hua. Kontratat e eksportit të financuar nga kjo hua do të garantohen nga agjencitë kredituese të eksportit ("ECA") të pranueshme për KfW.

Projekti përfshin ndërtimin e linjës së transmetimit 400 kV në Shqipëri dhe Mal të Zi dhe do të zbatohet në bashkëpunim nga KESH dhe Montenegrin Elektroprivreda Cme Gore A.D ("EPCG"), siç është përcaktuar në memorandumun e mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë shqiptare dhe Qeverisë së Malit të Zi. KESH-i do t'i japë pjesë të fondeve EPCG-së për të financuar investimin në Mal të Zi, siç është rënë dakord në memorandumun e mirëkuptimit ndërmjet KESH-it, EPCG-së dhe KfW-së. Një marrëveshje e veçantë tripalëshe ndërmjet KESH-it, EPCG-së dhe KfW-së do të konkludohet për të përcaktuar detajet e projektit, procedurat e disbursimit dhe zbatimin e projektit.

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i huasë

1.1 KfW-ja do t'i japë KESH-it një hua që nuk do t'i kalojë një shumë prej

	38 580 000 euro
Në portionin (pjesën) e I në	
	3 580 000 euro
Në portionin e II deri në	
	35 000 000 euro
Dhe një kontribut financiar që nuk i kalon	
	5 320 000 euro

Huaja dhe kontributi financiar këtu e më poshtë së bashku do t'i referohet si "Fondet"

1.2 KESH-i do t'i përdorë fondet ekskluzivisht për prokurimet e mallrave dhe të shërbimeve për ndërtimin e linjës së transmetimit 400 kV ndërmjet Tiranës dhe Podgoricës (Projekt) dhe fillimisht të paguajë kostot e këmbimit në monedhë të huaj. KESH, EPCG dhe KfW do të përcaktojnë detajet e projektit, mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga fondet me anë të një marrëveshjeje të veçantë, e cila do të përfshijë gjithashtu, çdo përcaktim të bërë për qëllimet e përputhjes me kushtet e ECA (Agjencisë Kredituese të Eksportit).

1.2 Taksat dhe detyrimet e tjera publike që do të lindin nga KESH-it, sikurse dhe detyrimet importuese nuk do të financohen nga fondet.

Neni 2

Disbursimi

2.1 Subjekti i kushteve të parashtruara në nenin 11.2 të kësaj Marrëveshjeje KfW-ja do t'i disbursojë fondet si më poshtë:

a) Pjesa e I-rë e huasë do të disbursohet në përputhje me progresin e projektit dhe sipas kërkesës së KESH-it dhe EPCG-së.

b) Pjesa e II-të e huasë do të disbursohet në përputhje me furnizimin e materialeve dhe me dërgimin e shërbimeve, siç është rënë dakord në kontratën e eksportit.

c) Kontributi financiar do të disbursohet në përputhje me progresin e projektit dhe sipas kërkesës së KESH-it dhe EPCG-së.

2.2 Me anën e një marrëveshjeje të veçantë KESH-i, EPCG-ja dhe KfW-ja do të përcaktojnë procedurat e disbursimit, në veçanti evidencat që provojnë se fondet e kërkuara janë përdorur për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

2.3 Në rast se çmimet totale të mallrave dhe shërbimeve që do financohen nga fondet e rena dakord në kontratat e eksportit zvogëlohen gjatë periudhës së dibursimit, KfW-ja do të zvogëlojë për rrjedhojë pjesën e II-të të huasë.

2.4 KfW-ja do të ketë të drejtën të refuzojë të bëjë disbursimet pas 31.12.2008. Në rast se zbatimi i kontratave të eksportit vonohet, KfW-ja, megjithatë, sipas kërkesës së KESH-it do të marrë në konsideratë nëse, dhe në çfarë kushtesh ky afat mund të shtyhet.

Neni 3

Detyrimet angazhuese, interesi dhe ripagesa

3.1 KESH-i do të paguajë nga burimet e veta një tarifë të detyrueshme të pakthyeshme prej 1/4% p.a për një nga shumat e huasë së padisbursuar të pjesës (Portion) I dhe pjesës II. Tarifa e detyruar për pjesën e II-të do të llogaritet për një periudhë që fillon nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe mbaron në datën, në të cilat disbursimet janë debitore. Tarifa e detyruar për pjesën e I-rë do të llogaritet për një periudhë që fillon 3 muaj pas nënshkrimit të Marrëveshjes dhe mbaron në datën në të cilat disbursimet janë debitore.

3.2 KESH-i do të formojë burimet e veta për t'i paguar KfW-së, brenda 90 ditëve pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje huaje nga KfW-ja, por në çdo rast para disbursimit të parë nga kjo hua, një tarifë menaxhimi të pakthyeshme prej 1% për të gjithë shumën e pjesës së II-të të përmendur në nenin 1.1 këtu.

3.3 KESH-i do të paguajë interes në pjesën e I-rë të huasë në një interes prej 0,75% p.a.

3.4 Interes në pjesën e II të huasë.

3.4.1 KESH-i do t'i paguajë interes KfW-së për çdo shumë të disbursuar (pjesë huaje) në një përqindje vjetore të barabartë me totalin e (i) përqindjes së ofruar nga bankat europiane (Euribor) në lidhje me çdo periudhë interesi (Periudhë interesi), siç specifikohet në lidhje me çdo pjesë huaje, në përputhje me nenet 3.4.2 dhe 3.4.3 plus (ii) një kufi prej 0.65% p.a.

3.4.2 Euribor-i i aplikueshëm është norma e interesit e përcaktuar nga KfW, që është e njëjtë me kuptimin aritmetik të normës së interesit për vit (e rrumbullakosur në 1/16 të një pike përqindje, nëse është e nevojshme) të kuotuar në *Telerate Page 248*. Në rast se këto përqindje të ofruara nuk shfaqen në faqen *Telerate* të përmendur, me përqindjet e kuotuar nga faqja Euribor e Rojterit, në ose rreth orës 11a.m, ora e Brukselit në ditën e dytë të ditëve bankare të Frankfurtit, para ditës së parë të periudhës së interesit përkatës, në një përqindje në të cilat huatë me maturim të njëjtë (ose nëse nuk ka të njëjta të krahasueshme) për një periudhë të tillë interesi në euro për shumat e krahasueshme me pjesën e huasë respektive që ofrohen nga bankat në tregun europian.

3.4.3 Nëse kuotimet e Euriborit nuk disponohen në faqen *Telerate 248* dhe të Rojterit, Euribori i aplikueshëm do të jetë përqindja e interesit (e rrumbullakosur në 1/16 të një pike përqindje, nëse është e nevojshme) që KfW përcakton të jetë kuptimi aritmetik i normave të interesit për vit, për të cilat huatë në euro të një shume të krahasueshme me pjesën e huasë respektive me maturime të njëjta (ose nëse nuk ka të njëjta të krahasueshme) për një periudhë të tillë interesi në euro u ofrohen bankave në tregun e euros nga tri banka ndërkombëtare, të cilat kanë vendndodhjen e tyre ose një zyrë në Frankfurt am Main, të caktuar nga KfW-ja. Nëse një ose të dyja këto banka nuk arrijnë të sigurojnë një normë interesi kur supozohet ta bëjë këtë, Euribori i aplikueshëm do të jetë

norma e interesit e kuotuar për shumat dhe maturimet korresponduese zyra të tjera të bankave në Londër ose institucionet financiare që përcakton KfW-ja (në konsultim me KESH-in) në datën që është dy ditë bankare Frankfurti përpara ditës së parë të periudhës së interesit.

3.4.4 Nëse mbi disbursimin e plotë të pjesës II të specifikuar në nenin 1.1 KESH-i ka opsionin, subjekt i nenit 3.4.6 më poshtë, për të kërkuar për periudhën e mbetur një ndryshim nga një normë interesi e ndryshueshme sipas nenit 3.4.1, në një interes me normë fikse (një ndryshim i tillë të bëhet konvertim). Një interes i tillë fiks do të jetë i njëjtë me shumën e (i) kostove të fondit efektiv të KfW-së në tregun e kapitaleve të euros për maturimet, që përkojnë sa më shumë me skedulimin e maturimit për këtë shumë huaje plus (ii) një kufi prej 0.65%p.a.

3.4.5 Nëse KESH-i kërkon një konvertim sipas nenit 3.4.4 duhet të aplikojë si më poshtë:

KESH-i duhet të njoftojë KfW-në në përputhje me aneksin 2 të kësaj Marrëveshjeje huaje. Njoftimi i KESH-it do të deklarojë datën e konvertimit të paramenduar dhe do të bëhet së paku 15 ditë bankare në Frankfurt përpara kësaj date.

Në kohën e duhur, por jo më vonë se 4 ditë bankare në Frankfurt përpara datës së konvertimit të paramenduar, KfW-ja do t'i dorëzojë KESH-it një kuotim jo të detyrueshëm të një përqindjeje interesi fiks, i cili do të aplikohet ashtu sikurse për nenin 3.4.4 ishin data e këtij kuotimi e shqyrtuar në datën e konvertimit. Pas kësaj, KESH-i do t'i konfirmojë KfW-së konvertimin, shumën dhe datën jo më vonë se 3 ditë bankare në Frankfurt am Main përpara datës së rënë dakord për konvertim. Pastaj KfW-ja do të bëjë efektive konvertimin siç konfirmohet nga KESH-i dhe do t'ia bëjë të ditur KESH-it këto norma fikse të interesit që do të fiksohen për datën e konvertimit.

Nëse KESH-i e ka kundërshtuar përqindjen e interesit fiks, siç bëhet e ditur nga KfW-ja, ose nëse KfW-ja nuk ka marrë konfirmimin e KESH-it 3 ditë bankare të Frankfurtit am Main përpara datës respektive të konvertimit, atëherë KfW-ja nuk do ta vërë në zbatim këtë konvertim.

3.4.6 Çdo konvertim mund të bëhet vetëm në një ditë pagese. Rikonvertimi nga një financim me përqindje fikse në një financim me përqindje të ndryshueshme do të përjashtohet.

3.5 Interesi do të rritet që nga datat që disbursimet janë debituar deri në datat, në të cilat kështet e ripagesave respektive do të kreditohen në llogarinë e KfW-së të përmendur në nenin 3.13. KESH-i do t'i paguajë KfW-së interesin për borxhet sipas neneve 3.8 dhe 3.9, sipas mënyrës dhe në datat e përmendura më poshtë (secila prej tyre një datë pagese):

A) përpara datës së pagesës së kështit të parë të ripagesës KESH-i do të paguajë detyrimet e angazhimit për huanë dhe interesin për huanë gjashtëmujore më 30 qershor dhe më 30 dhjetor të çdo viti për gjysmën e vitit që mbaron;

B) në datën e pagesës së kështit të parë të ripagesës, së bashku me një kësht të tillë;

C) pas kësaj në datat e tjera të ripagesës të ripagesës së kësteve sipas nenit 3.6.

3.6 KESH-i do të ripaguajë pjesën e I-rë të huasë si më poshtë:

Kështet	Data		Shuma	Euro
1	30 qershor	2015	58 000,00	Euro
2	30 dhjetor	2015	58 000,00	Euro
3	30 qershor	2016	58 000,00	Euro
4	30 dhjetor	2016	58 000,00	Euro
5	30 qershor	2017	58 000,00	Euro
6	30 dhjetor	2017	58 000,00	Euro
7	30 qershor	2018	58 000,00	Euro
8	30 dhjetor	2018	58 000,00	Euro
9	30 qershor	2019	58 000,00	Euro
10	30 dhjetor	2019	58 000,00	Euro
11	30 qershor	2020	58 000,00	Euro
12	30 dhjetor	2020	58 000,00	Euro
13	30 qershor	2021	58 000,00	Euro
14	30 dhjetor	2021	58 000,00	Euro

15	30 qershor	2022	58 000,00	Euro
16	30 dhjetor	2022	58 000,00	Euro
17	30 qershor	2023	58 000,00	Euro
18	30 dhjetor	2023	58 000,00	Euro
19	30 qershor	2024	58 000,00	Euro
20	30 dhjetor	2024	59 000,00	Euro
21	30 qershor	2025	59 000,00	Euro
22	30 dhjetor	2025	59 000,00	Euro
23	30 qershor	2026	59 000,00	Euro
24	30 dhjetor	2026	59 000,00	Euro
25	30 qershor	2027	59 000,00	Euro
26	30 dhjetor	2027	59 000,00	Euro
27	30 qershor	2028	59 000,00	Euro
28	30 dhjetor	2028	59 000,00	Euro
29	30 qershor	2029	59 000,00	Euro
30	30 dhjetor	2029	59 000,00	Euro
31	30 qershor	2030	59 000,00	Euro
32	30 dhjetor	2030	59 000,00	Euro
33	30 qershor	2031	59 000,00	Euro
34	30 dhjetor	2031	59 000,00	Euro
35	30 qershor	2032	59 000,00	Euro
36	30 dhjetor	2032	59 000,00	Euro
37	30 qershor	2033	59 000,00	Euro
38	30 dhjetor	2033	59 000,00	Euro
39	30 qershor	2034	59 000,00	Euro
40	30 dhjetor	2034	59 000,00	Euro
41	30 qershor	2035	59 000,00	Euro
42	30 dhjetor	2035	59 000,00	Euro
43	30 qershor	2036	59 000,00	Euro
44	30 dhjetor	2036	59 000,00	Euro
45	30 qershor	2037	59 000,00	Euro
46	30 dhjetor	2037	59 000,00	Euro
47	30 qershor	2038	59 000,00	Euro
48	30 dhjetor	2038	59 000,00	Euro
49	30 qershor	2039	59 000,00	Euro
50	30 dhjetor	2039	59 000,00	Euro
51	30 qershor	2040	59 000,00	Euro
52	30 dhjetor	2040	59 000,00	Euro
53	30 qershor	2041	59 000,00	Euro
54	30 dhjetor	2041	59 000,00	Euro
55	30 qershor	2042	59 000,00	Euro
56	30 dhjetor	2042	59 000,00	Euro
57	30 qershor	2043	59 000,00	Euro
58	30 dhjetor	2043	59 000,00	Euro
59	30 qershor	2044	59 000,00	Euro
60	30 dhjetor	2044	59 000,00	Euro
61	30 qershor	2045	59 000,00	Euro

3.7 Subjekti i përputhjes me kushtet përkatëse të AKE-së (Agjencia Kredituese e Eksportit), KESH-i do të ripaguajë pjesën II-të të huasë në 20 këste të njëpasnjëshme të barabarta

gjashtëmuajore, kësti i parë i të cilëve do të bëhet 6 muaj pas datës së gatishmërisë për operim të projektit, por jo më vonë se data 30.6.2008. Të dhënat që provojnë gatishmërinë për operimin e projektit do të jepen nëpërmjet konfirmimit të bërë në përputhje me aneksin X të kësaj Marrëveshjeje. Sapo të jetë vendosur skedulimi i ripagesave, KfW-ja do t'ia dërgojë atë KESH-it me letër postare të regjistruar.

Skedulimi i ripagesave do të përbëjë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje huaje.

Në rast se kontratat eksportuese janë subjekt i kushteve të kontratave të veçanta të AKE-së, të cilat nuk do të lejojnë për të fiksuar një datë të përbashkët për gatishmërinë e operimeve dhe për rrjedhojë një skedulim ripagese të përbashkët për të gjithë huanë, huaja do të ndahet në këste të veçanta për t'u përshtatur me datat individuale të gatishmërisë të operimeve dhe skedulet e ripagesës. Menjëherë sapo huaja disbursohet plotësisht, KfW do të ketë të drejtën, nëse është në përputhje me kushtet respektive të AKE-së, të konsolidojë ripagesën e kësteve të ndara në një skedul ripagese të përbashkët për të gjithë huanë. Fjalat 3 dhe 4 e këtij neni do të aplikohet për rrjedhojë.

3.8 Nëse këstet e ripagesës së pjesës së I-rë nuk janë në dispozicion të KfW-së kur duhen, KfW do të ketë të drejtën të rrisë normën e interesit mbi borxhet duke u bazuar në normën bazë të interesit +3%p.a për një periudhë që fillon me datën e pagesës dhe që mbaron në datën në të cilën ripagesat kreditohen në llogarinë e KfW-së, e cila është specifikuar në nenin 3.13. "Përqindja bazë" është norma e interesit e nxjerrë nga Deutsche Bundesbank si bazë interesi në përqindjen e aplikueshme për datën përkatëse të pagesës. Për ripagesat e kësteve të papaguara të pjesës II, KfW do të ketë të drejtën të rrisë përqindjen e interesit me 3%p.a. Interesi për këstet e papaguara të ripagesës do të paguhet pa vonesë me kërkesën e parë të KfW-së.

3.9 KfW mund t'i kërkojë KESH-it të paguajë dëmet për pagesat e interesit të papaguar ose për pagesat e papaguara për detyrimet e angazhimit në një shumë njëherëshe prej 3% mbi përqindjen bazë efektive në datën faktuar të pagesës. Kjo shumë e njëhershme do të llogaritet nga data e pagesës deri në datën në të cilën interesi ose pagesat e detyrueshme të angazhimit kreditohen në llogarinë e KfW-së e specifikuar kjo në nenin 3.13 dhe do të paguhet që në kërkesën e parë të KfW-së.

3.10 Detyrimi i angazhimit, interesi dhe detyrime të tjera shtesë në zbatim të nenit 3.8 dhe 3.9 do të llogariten në bazë të një viti me 360 ditë dhe 30 ditë muaji.

Për pjesën e II-të të huasë do të aplikohet si më poshtë: me përjashtim të periudhës së parë të interesit në lidhje me shumën e huasë, çdo periudhë interesi do të fillojë në datën e pagesës (duke e përfshirë dhe datën) dhe do të mbarojë në ditën menjëherë para datës së pagesës tjetër. Periudha e parë e interesit do të fillojë në datën e vlerës të disbursimit të kësaj shume huaje dhe do të mbarojë në ditën menjëherë përpara datës së pagesës tjetër. Shumat e huasë që kanë një normë të ndryshueshme interesi do të llogariten në bazë të një viti me 360 ditë për numrin aktual të ditëve që rrjedhin.

3.11 Shumat e huasë të ripaguara, të padisburuara ose paramaturuara të pjesës së I-rë do të kreditohen në propocion të njëjtë përkundrejt të gjitha kësteve ripaguese të prapambetura të pjesës së thënë, vetëm nëse KfW-ja përcakton sipas dëshirës së vet një mënyrë të ndryshme kompensimi për një çështje të veçantë, veçanërisht në rastin e shumave të një vëllimi më të vogël. Shumat e huasë të ripaguara të padisburuara ose paramaturuara të pjesës së II-të do të kreditohen përkundrejt pagesës së kësteve ripaguese që vazhdojnë në pjesën e II-të në përputhje me skedulin e ripagesës, derisa të bihet dakord për një mënyrë kompensimi të ndryshme për çështje të veçanta.

3.12 KfW-ja do të ketë të drejtën të kreditojë, sipas dëshirës së vet, pagesat e marra përkundrejt pagesave sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas marrëveshjeve të tjera të huasë të konkluduara ndërmjet KfW-së dhe KESH-it.

3.13 KESH-i do t'i bëjë të gjitha pagesat në euro në numrin e llogarisë së KfW-së nr.31.19354053 në KfW Frankfurt am Main (BLZ 500 204 00, BIC KFWIDEFF në lidhje me referencën Ref.viti/muaji/data). Nuk do të lejohet asnjë kompensim i kundërkërkesës përkundrejt këtyre pagesave. Detyrimet e pagesave të KESH-it do të mbyllën vetëm nëse pagesat janë kredituar në llogarinë e përmendur më sipër, në monedhën e Republikës Federale Gjermane dhe janë në dispozicion të KfW-së.

Neni 4

Siguracioni plus dhe *Pari Passu*

4.1 Në rast se KESH-i do të garantojë sigurinë e ndonjë personi tjetër ose të drejta të tjera duke bërë të mundur një marrëveshje preferenciale të klemave të ndonjë prej asetëve të KESH-it, pronës ose të ardhurave, KESH-i duhet menjëherë të njoftojë KfW-në dhe, sipas kërkesës së tij, të krijojë siguri, e cila siguron në mënyrë të njëjtë dhe klemat e KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje.

4.2 Dispozita e mësipërme e këtij neni nuk do të aplikohet për ndonjë të drejtë siguracioni të krijuar për pronën në kohën e blerjes këtu dhe vetëm si garanci për pagesën e çmimit të blerjes ose financimin e kësaj prone.

4.3 Në shkallën e lejuar nga ligjet e aplikueshme, KESH-i merr përsipër që të gjitha detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje do të radhiten *pari passu* me të gjitha detyrimet e tij të pagesave aktuale dhe në të ardhmen dhe do të paguhën si të tilla.

Neni 5

Lenia pezull e disbursimeve dhe ripagesat e parakohshme

5.1 KESH-i mund të heqë dorë nga disbursimi i shumave të huasë vetëm me pëlqimin e mëparshëm të KfW-së.

5.2 KESH-i mund:

a) të heqë dorë nga disbursimi i shumave të huasë të pjesës së II-të vetëm me pëlqimin e mëparshëm të KfW-së. Nëse nuk janë bërë disbursime sipas pjesës II të kësaj Marrëveshjeje huaje nga data në të cilën Huamarrësi heq dorë nga disbursimi, megjithatë, KfW-ja do të marrë një gjobë të paripagueshme të barabartë me dyfishin e shumës së llogaritur në përputhje me nenin 3.2 *pro rata* me shumën e hequr dorë;

b) të parapaguajë pjesën e II-të të çdo date pagese vetëm në shumën e një ose më shumë kësteve ripaguese që kanë një përqindje interesi të ndryshueshëm në përputhje me nenin 3.4 në rast se Huamarrësi e ka njoftuar KfW-në së paku 30 ditë. Çdo njoftim i tillë do të jetë i parevokueshëm, do të specifikojë datën në të cilën parapagesa do të bëhet dhe për rrjedhojë dhe shumën, dhe do ta detyrojë Huamarrësin t'i paguajë KfW-së shumën e përmendur këtu;

c) në observimin e 30 ditëve të njoftimit ripagesa e parakohshme e pjesës II vetëm në një shumë prej një ose më shumë kësteve ripaguese, të cilat do të kenë një interes fiks së bashku me pagesën e një kompensimi për ripagesat e lëna pezull që do të përcaktohen nga KfW dhe do të llogariten mbi bazat e situatës së tregut të kapitalit mbizotërues për kohën dhe të marrë në konsideratë për fitimet e interesit të humbur dhe mundësitë riinvestuese për termat origjinalë të huasë. Mbi bazën e ripagesës së pjesës II, Huamarrësi mund të parapaguajë plotësisht ose pjesërisht pjesën I në çdo kohë.

5.3 KfW-ja nuk mund të lërë pezull disbursimet vetëm nëse:

a) KESH-i ose garantuesi nuk arrin të kryejë detyrimet e pagesës ndaj KfW-së, si dhe kur duhet;

b) Janë shkelur detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje, sipas marrëveshjes së veçantë që lidhet me këtë Marrëveshje ose sipas marrëveshjes së garancisë;

c) KESH-i nuk është në gjendje të provojë se arkëtimet nga fondet janë përdorur për qëllimin e përcaktuar;

d) Dalin rrethana të jashtëzakonshme që i paraprijnë ose që rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e projektit, ose kryerjen e detyrimeve të pagesës të marra nga KESH-i sipas kësaj marrëveshjeje.

5.4 Nëse ndonjë nga situatat e specifikuar në nenin 5.3 a), b) ose c) ka ndodhur dhe nuk janë eliminuar brenda një periudhe kohe të specifikuar nga KfW-ja, e cila do të jetë së paku 30 ditë, KfW mund:

a) në rastet e specifikuar në nenin 5.3 a) ose 5.3 b), të kërkojë ripagesë të menjëhershme të

të gjitha shumave të huasë së prapambetur, si dhe pagesën e të gjithë interesit të rritur dhe të gjitha detyrimet e tjera dytësore;

b) në rastin e specifikuar në nenin 5.3 c), të kërkojë ripagesën e menjëhershme të shumave të kësaj huaje, përderisa KESH-i nuk është në gjendje të provojë t'i ketë përdorur për qëllimet e përcaktuara.

Neni 6

Kostot dhe detyrimet publike

6.1 KESH-i do të bëjë çdo dhe të gjitha pagesat që janë efektive sipas kësaj Marrëveshjeje pa hequr asnjë zbritje për taksat, detyrimet e tjera publike ose kostot e tjera dhe do të paguajë kostot e rritura transferuese dhe konvertuese në lidhje me disbursimin e huasë.

6.2 KESH-i do të mbulojë të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike jashtë Republikës Federale Gjermane në lidhje me konkluzionet dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Çdo taksë ose detyrim që mbahet me anën e zvogëlimit jashtë Republikës Federale Gjermane do t'i ngarkohet dhe do të rifinancohet nga KESH-i. Në rast se ky detyrim ndalohet me ligj, pagesat e bëra nga KESH-i do të dalin nga shumat e nevojshme për KfW-në për të marrë të plotë shumën e llogaritur në zbatim të nenit 3 pas heqjes së taksave ose detyrimeve.

6.3 Përpara disbursimit të parë nga huaja, KESH-i do t'i japi KfW-së evidencë që të vërtetojë që KfW-ja është e shkarkuar nga çdo dhe të gjitha taksat e interesit dhe të ardhurave të detyrimit të angazhimit në Shqipëri kur subvencionoi huanë.

Neni 7

Dorëzimi

7.1 KESH-i do t'i dorëzojë një pjesë të fondeve EPCG për financimin e kostove investuese të projektit në territorin e Malit të Zi. Shuma e fondit të dorëzuar për çdo pjesë të huasë dhe të kontributit financiar do të përcaktohet sipas një ndarje të kostove totale në monedhë të huaj në territorin e Malit të Zi në lidhje me kostot totale të projektit në monedhë të huaj, të bazuar në llogaritjen finale të çmimit në kontratë për kontraktorin e përgjithshëm.

7.2 KESH-i do të dorëzojë fondet me të njëjtat kushte në lidhje me maturimin, normën e interesit dhe taksat, ashtu siç ai i merr ato.

7.3 Në marrëveshjen e dorëzimit që do të konkludohet, KESH-i do të aplikojë tek EPCG kushtet e neneve 1.2, 1.2, 6.1, 6.2, 6.3, 11.1 a), 11.1d-n dhe 12.1.

7.4. Detajet e dorëzimit do të përcaktohen në një marrëveshje dorëzimi ndërmjet KESH-it dhe EPCG-së, për të cilën të konkludohet. Konkluzioni i kësaj marrëveshjeje dorëzuese është një parakusht për disbursimin e fondeve siç përcaktohet në nenin 11.2 a).

7.5 Dorëzimi i fondeve nuk duhet në asnjë mënyrë të ndikojë dhe të zvogëlojë detyrimet që KESH-i ka përkundrejt KfW-së.

Neni 8

Garancia

Për të pasur garancinë për huanë Qeveria e Republikës së Shqipërisë (Garantuesi) do të bëjë një marrëveshje të veçantë garancie me KfW-në (marrëveshja e garancisë).

Neni 9

Garancia nga Agjencia e Kreditimit të Eksportit

KfW-ja do të ketë pretendime që dalin nga pjesa e II-të të garantuara nga AKE, të pranuar nga KfW-ja përpara disbursimit të pjesës së dytë. Efektiviteti i patërhequr i garancisë së përmendur do të jetë një kusht paraprak për disbursimin e pjesës së II-të.

Neni 10

Vlefshmëria e kësaj Marrëveshjeje dhe përfaqësimi

10.1 Në kohën e duhur, përpara disbursimit të parë KESH-i do t'i paraqesë KfW-së evidencë të kënaqshme për të ku të vërtetojë se:

a) KESH-i i ka plotësuar të gjitha kërkesat sipas ligjit shqiptar, për përvetësimin e rregullt të të gjitha detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje;

b) Garantuesi i ka plotësuar të gjitha kërkesat e tij kushtetuese dhe ligjet e tjera për përvetësim të rregullt të të gjitha detyrimeve të tij sipas marrëveshjes së garancisë.

10.2 Drejtori i Përgjithshëm i KESH-it dhe persona të tjerë të caktuar nga ai për KfW-në dhe të autorizuar për nënshkrimet autentike nga ai, do të përfaqësojnë KESH-in në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Fuqia e prezantimit nuk do të skadojë deri në revokimin e tij të shprehur nga përfaqësuesi i KESH-it i autorizuar në kohën që është marrë nga KfW-ja.

10.3 Amendamentet ose shtesat e kësaj Marrëveshjeje dhe çdo njoftim ose deklaratë e paraqitura nga Palët Kontraktuese sipas kësaj Marrëveshjeje duhet të jenë me shkrim. Çdo njoftim ose deklaratë që është marrë një herë duhet të arrijë në adresën e mëposhtme të Palës Kontraktuese korresponduese ose në adresën tjetër të Palës Kontraktuese korresponduese, siç njoftohet nga Pala tjetër Kontraktuese.

Për KfW: KfW
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany
Fax: 00 49 69 7431-2944

Për KESH: Korporata Elektroenergetike Shqiptare sh.a
Blloku "Vasil Shanto"
Tiranë-Albania

Neni 11

Projekti

Projekti do të zbatohet së bashku nga KESH-i dhe EPCG-ja e Malit të Zi. Të gjitha vendimet kyçe në lidhje me zbatimin e projektit do të arrihen me konsensus ndërmjet KESH-it dhe EPCG-së. Në rast se nuk arrihet një konsensus ndërmjet KESH-it dhe EPCG-së votat e tyre do të vlerësohen sipas ndarjes së kostos totale të projektit në vendin përkatës dhe vendimi do të bëhet duke u bazuar në peshën e votave të KESH-it dhe EPCG-së.

Detajet e zbatimit të projektit do të vendosen në një marrëveshje të veçantë. Përderisa projekti mbulon territorin e Shqipërisë dhe të Malit të Zi dhe përderisa KESH do t'i dorëzojë një pjesë të fondeve EPCG-së për të financuar investimet në territorin e Malit të Zi, kjo marrëveshje e veçantë duhet të konkludojë ndërmjet KESH-it, EPCG-së dhe KfW-së.

11.1 KESH:

a) do të përgatisë, zbatojë, operojë dhe mirëmbajë projektin në përputhje me praktikatat financiare dhe inxhinierike dhe në përputhje me konceptin e projektit, siç është rënë dakord ndërmjet KESH-it, EPCG-së dhe KfW-së;

b) në konsensus me EPCG-në ka nënshkruar përgatitjen dhe supervizionin e konstruksionit të projektit, nga konsulentë të pavarur dhe të kualifikuar dhe do t'ia paraqesë zbatimin e projektit firmave të kualifikuara;

c) në konsensus me EPCG-në ka vlerësuar kontratat për shërbimet konsultuese që do të financohen nga fondet. Kostot për këto shërbime janë parafinancuar nga studimi shqiptar dhe fondi i ekspertëve dhe do t'i rimburohet atij menjëherë pas gatishmërisë për disbursimin e fondeve;

d) në konsensus me EPCG-në do të vlerësojë kontratat për materialet dhe shërbimet që do të financohen nga fondet, sipas tenderit ndërkombëtar në përputhje me direktivat prokuruese të KfW-së;

e) do të sigurojë financimin e plotë të projektit dhe, sipas kërkesës ta pajisë KfW-në me evidenca që vërtetojnë se kostot e papaguara nga fondet janë të mbuluara;

f) do të mirëmbajë ose shkaktojë të mirëmbajë libra dhe regjistra që tregojnë në mënyrë joekuivoke të gjitha kostot e materialeve dhe shërbimeve të kërkuara për projektin dhe të identifikojë qartë materialet dhe shërbimet e financuara nga fondet;

g) do të bëjë të mundur që përfaqësuesit e KfW-së të inspektojnë në çdo kohë librat dhe regjistrat e përmendur, sikurse dhe të gjithë dokumentacionin tjetër që lidhet me zbatimin e projektit dhe të vizitojnë projektin dhe të gjitha instalimet që lidhen me të;

h) do ta pajisë KfW-në me çdo lloj informacioni dhe regjistri për projektin dhe progresin e tij të mëtejshëm siç mund ta kërkojë KfW-ja;

i) do të informojë menjëherë KfW-në për çdo lloj rrethane që rrezikon seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e projektit;

j) nuk mund të sigurojë hipotekën, shitjet ose dispozita të tjera të aseteve, që formojnë pjesë të projektit, përpara ripagimit të plotë të huasë pa miratimin e mëparshëm të KfW-së;

l) sipas kërkesës së KfW-së do ta pajisë KfW-në me çdo lloj informacioni në lidhje me situatën financiare në KESH siç mund ta kërkojë KfW-ja;

m) sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 9 muaj pas mbylljes së çdo viti financiar t'i paraqesë KfW-së raportin e tij vjetor për çdo vit së bashku me bilancin dhe përfitimet, humbjet, si dhe me shënimet shpjeguese;

n) do t'u bëjë të mundur përfaqësuesve të KfW-së në çdo kohë të inspektojnë librat dhe regjistrat e KESH-it, të cilat do të reflektojnë aktivitetin e biznesit dhe qëndrimin financiar të KESH-it në përputhje me parimet e pranuar të llogarisë.

11.2 Konventat e mëposhtme specifike të projektit do të aplikohen:

Përpara disbursimit të parë KESH:

a) do të sigurojë evidencë se marrëveshja e dorëzimit ligjor dhe e detyrueshme është konkluduar me EPCG. Ajo do të jetë në përputhje me parimet e rëna dakord në memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet KESH-it, EPCG-së dhe KfW-së;

b) do të sigurojë evidencë se financimi i linjës së transmetimit 400 kV Elbasan-Tiranë duke përfshirë dhe N/st Tirana 2 është i siguruar;

c) do të sigurojë evidencë se njohja e tokës dhe rruga e duhur për përcaktimin e linjës është në përfundim e sipër.

11.3 KESH-i, EPCG-ja dhe KfW-ja do të parashtrojnë detaje për nenin 11.1 dhe 11.2 në një marrëveshje të veçantë.

11.4 Për transportin e materialeve që do të financohen nga huaja do të aplikohen kushtet e marrëveshjes qeveritare, të cilat janë të njohura për KESH-in.

Neni 12

Kushte të ndryshme

12.1 KESH-i do të sigurojë që të gjithë personat përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e projektit, vlerësimin e kontratës për furnizimet dhe shërbimet që do të financohen dhe me kërkesat e disbursimit të shumave të huasë nuk do të kërkojë që të marrë përsipër, të japë llogari, të subvencionojë, të premtojë ose të mbajë premtimin për pagesa të paligjshme ose për avantazhe të tjera në lidhje me këto taksa.

12.2 Nëse ndonjë nga këto kushte të kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha kushtet e tjera do të mbesin të paprekura. Çdo e çarë që do të rezultojë prej kësaj do të plotësohet me një kusht në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

12.3 Kjo Marrëveshje huaje është ligjërisht e pavarur nga kontratat e eksportit. KESH-i në kryerjen e të gjitha detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes së huasë, nuk mund të parashtrijë mbrojtje në lidhje me kontratën e eksportit.

12.4 KESH-i nuk mund të nënshkruajë ose të transferojë, të lërë peng ose të hipotekojë ndonjë pretendim nga kjo Marrëveshje.

12.5 Kjo Marrëveshje do të drejtohet nga ligji i Republikës Federale Gjermane. Vendi i kryerjes do të jetë Frankfurt am Main.

12.6 Të gjitha mosmarrëveshjet që dalin nga kjo Marrëveshje dhe të gjitha mosmarrëveshjet për rregullsinë e kësaj Marrëveshjeje dhe të marrëveshjes së arbitrazhit që nuk mund të zgjidhen në mënyrë miqësore ndërmjet Palëve Kontraktuese, do t'i paraqiten veprimeve të arbitrazhit në përputhje me marrëveshjen e arbitrazhit duke formuar një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Në mënyrë alternative KfW-ja rezervon të drejtën të institucionalizojë çdo veprim ligjor ose procese gjyqësore që dalin ose në lidhje me këtë Marrëveshje në ndonjë gjykatë kompetente të Republikës së Shqipërisë ose në gjyqësorin e distriktit në Frankfurt, Republika Federale Gjermane, ose në ndonjë gjykatë tjetër kompetente që ka juridiksion mbi KESH-in ose asetet e tij. KESH, këtu e më poshtë, pranon në mënyrë të përvokueshme juridiksionin e çdo gjykate.

12.7 Asnjë pagesë, këtu e më poshtë, për KfW-në nuk do të jetë në zbatim të ndonjë vlerësimi ose sipas rregullit të ndonjë gjykate tjetër ose do të operojë për të shkarkuar KESH-in nga detyrimet në lidhje me atë çfarë ajo është bërë, dhe deri në pagesën e plotë do të merret në llogaritjen e monedhës siç është ky detyrim. Në masën që shumën e ndonjë pagese të tillë do të paguhet në konvertimin e llogaritjes të monedhës për të cilën do të bëhet pagesa do të zvogëlojë shumën e detyrimit përkatës të shprehur në llogaritjen e monedhës, KESH do të mbetet debitor në një shumë të tillë duke u bazuar në konvertimin e llogaritjes së monedhës për të cilën u bë pagesa, në një shumë të barabartë me diferencën.

KLAUZOLË ARBITRAZHI

Të gjitha debatet që dalin nga Marrëveshja e mësipërme dhe të gjitha debatet për rregullsinë e Marrëveshjes së mësipërme dhe kjo klauzolë arbitrazhi që nuk mund të vendoset miqësisht midis palëve kontraktuese do t'i paraqiten veprimeve të arbitrazhit, siç është rënë dakord në marrëveshjen e arbitrazhit që lidhet me Marrëveshjen e huasë datë _____. Rregullsia e marrëveshjes së thënë të arbitrazhit do të shtyhet deri sa detyrimet e pagesave sipas Marrëveshjes së mësipërme janë kryer plotësisht.

12.8 Asnjë mangësi për t'u ushtruar nga ana e KfW-së të çdo të drejte këtu e më poshtë do të operojë si një akt dorëheqje ose do të ushtrojë ndonjë të drejtë të vetme ose të pjesshme për të mos pranuar ushtrimin e ndonjë ose të tjerave në të ardhmen .

12.9 Në masën që KESH mundet tani ose në të ardhmen për çdo pretendim juridiksioni për imunitetin e aseteve të veta nga përshtatja, zbatimi, lidhje ose procese të tjera ligjore dhe në shkallën që një juridiksion të tillë mund t'ia atribuojë vetvetes ose aseteve të tij këtë imunitet, KESH-i këtu pranon në mënyrë të përvokueshme të mos pretendojë dhe në mënyrë të përvokueshme të përjashtojë këtë imunitet në shkallën më të plotë të lejuar nga ligjet e këtij juridiksioni.

12.10 Kjo Marrëveshje huaje nuk do të hyjë në fuqi deri sa marrëveshja qeveritare në të cilën është bazuar ajo të hyjë në fuqi.

MARRËVESHJE ARBITRAZHI

Duke iu referuar nenit 9, 4 Marrëveshjes së huasë dhe financiare ndërmjet KFW, Frankfurt am Main (“KFW”) dhe @ Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a., Tiranë, Shqipëri (“Huamarrësi dhe Pranuesi”) datë _____ dhe duke iu referuar nenit 5.3 të Marrëveshjes së Garancisë ndërmjet KFW dhe Ministrisë së Financave (“Garantuesi”) datë _____

Linja e Transmetimit 400 kV Tiranë-Podgoricë, KfW-ja, Huamarrësi dhe Garantuesi këtu e më poshtë janë dakord si më poshtë:

Neni 1

Të gjitha debatet nga Marrëveshja e huasë dhe ajo financiare dhe nga marrëveshja e garancisë dhe të gjitha debatet për vlefshmërinë e Marrëveshjes së huasë dhe asaj financiare, marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së arbitrazhit që nuk mund të zgjidhen në mënyrë miqësore nga Palët Kontraktuese do të zgjidhen përfundimisht dhe ekskluzivisht nga Gjykata e Arbitrazhit.

Neni 2

Palët në veprimet arbitrazhe do të jenë Garantuesi dhe KESH-i, nga njëra anë, dhe KfW-ja nga pala tjetër KfW-ja ka të drejtë të ndërmarrë një veprim kundrejt Garantuesit dhe KESH-it të ndarë për ose për të dy së bashku. Në mënyrë të ngjashme, Garantuesi dhe KESH-i kanë të drejtë veç e veç ose së bashku të kryejnë një veprim kundrejt KfW-së.

Neni 3

3.1 Gjykata e Arbitrazhit do të përbëhet nga tre gjykatës arbitrazhi të përcaktuar si më poshtë:

Njëri gjykatës arbitrazhi do të përcaktohet nga Garantuesi vetëm ose, nëse Garantuesi nuk ka ndërhyrë ose akoma nuk është futur në veprime, nga KESH-i, gjykatësi i dytë i arbitrazhit nga KfW-ja dhe gjykatësi i tretë i arbitrazhit (kryetari) do të përcaktohet me marrëveshje nga palët ose nëse palët nuk bien dakord brenda 60 ditësh pas marrjes së kërkesës për arbitrazh nga mbrojtësi, me aplikimin nga pala tjetër nga presidenti i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë ose nëse dështon edhe kjo, nga kryetari i Komitetit Kombëtar të Zvicrës të Dhomës Internacionale të Tregtisë. Nëse ndonjë nga palët nuk bie dakord në përcaktimin e një gjykatësi arbitrazhi të tillë, i cili do të përcaktohet nga kryetari.

3.2 Në rast se ndonjë gjykatës arbitrazhi, i përcaktuar sipas kushteve të mësipërme, dëshiron të japë dorëheqjen ose bëhet nuk është në gjendje të veprojë si gjykatës arbitrazhi, pasardhës i tij do të përcaktohet në të njëjtën mënyrë si me arbitrin origjinal. Pasardhësi do të ketë të gjithë fuqinë dhe detyrimet e thëna për gjykatësin e arbitrazhit origjinal.

Neni 4

4.1 Veprimet arbitrazhe do të institucionalizohen me paraqitjen e një deklarate të shkruar të pretendimit, të një pale për palën tjetër. Deklarata e një pretendimi të tillë do të japë natyrën e pretendimit, dëmshpërblimit ose kompensimin e kërkuar dhe emrin e arbitrit të përcaktuar nga pretenduesi, me kusht që pretenduesi është autorizuar të përcaktojë një arbitër sipas nenit 3.1 këtu.

4.2 Brenda 30 ditësh pas marrjes së një deklarate të tillë pretenduese, i akuzuari do t'i njoftojë pretenduesit emrin e arbitrit të përcaktuar nga ai, me kusht që i akuzuari të jetë i autorizuar të përcaktojë një arbitër sipas nenit 3.1 këtu.

Neni 5

Gjykata e Arbitrazhit do të mblihdhet në një kohë që do të jetë fiksuar nga kryetari. Nëse palët nuk kanë rënë dakord për vendin e veprimeve arbitrazhe, një vend i tillë do të përcaktohet nga kryetari.

Neni 6

Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë mbi bazën e kompetencave të saj. Ajo do të përcaktojë procedurën e saj sipas rregullave procedurave të përgjithshme të njohura. Në çdo rast të dyja palët do të jenë në gjendje të dëgjojnë njëra-tjetrën sipas rregullit të vendosur. Gjykata Arbitrazhe mundet, sidoqoftë, të arrijë një veprim pavarësisht nga mosrënia dakord nga njëra palë ose tjetra. Të gjithë vendimet e Gjykatës së Arbitrazhit do të kërkohen të miratohen të paktën nga dy arbitra.

Neni 7

Gjykata e Arbitrazhit do të paraqesë me shkrim vendimin e vet së bashku me arsyet. Një vendim i nënshkruar nga të paktën dy arbitra do të përbëjë vendimin e Gjykatës së Arbitrazhit. Secila palë do të marrë një kopje të vendimit. Vendimi do të jetë detyrues dhe final. Nga përshkrimi i kësaj Marrëveshjeje, të dyja palët marrin përsipër detyrimin për t'iu bindur një vendimi të tillë.

Neni 8

8.1 Palët do të bien dakord për pagesën e arbitrave dhe personave të tjerë që do të kërkohen të drejtojnë procesin e arbitrazhit.

8.2 Nëse palët nuk bien dakord përpara mbledhjes së Gjykatës së Arbitrazhit, Gjykata e Arbitrazhit do të fiksojë një pagesë të mjaftueshme. Secila palë do të përballojë shpenzimet e veta që rrjedhin nga procesi i arbitrazhit. Shpenzimet e Gjykatës së Arbitrazhit do të krijohen nga pala kundrejt së cilës është marrë vendimi. Nëse asnjë palë nuk merr një vendim të plotë, shpenzimet do të përballohen proporcionalisht nga palët.

8.3 Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë përfundimisht mbi të gjitha pyetjet lidhur me shpenzimet.

8.4 Palët do të jenë të detyruara bashkë ose veçmas për pagimin e pagesave të personave të specifikuar në nenin 8.1.

Neni 9

Ndonjë ose të gjitha shënimet dhe deklaratat e paraqitura nga palët dhe Gjykata e Arbitrazhit në lidhje me veprimet e arbitrazhit do të jenë të shkruara. Shënime dhe deklarata të tilla do të merren kur ato mbërrijnë në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese korresponduese ose në një adresë tjetër të tillë të palës kontraktuese korresponduese, siç shënohet për palën kontraktuese.

Për KfW:
KfW
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Republika Federale e Gjermanisë
Fax: +49697431-2944

Për Garantuesin:
Ministria e Financave
Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë
Shqipëri

Për Huamarrësin:
Korporata Elektroenergjetike Shqiptare Sh.a.
Blloku “Vasil Shanto”
Tiranë
Shqipëri

E bërë në 3 origjinalë në gjuhën angleze

MARRËVESHJE GARANCIE

Linja 400 kV e transmetimit Tiranë-Podgoricë

MIDIS KFW, FRANKFURT AM MAIN (KFW) DHE MINISTRISË SË FINANCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (GARANTUESI) LIDHUR ME MARRËVESHJEN FINANCIARE DHE TË HUASË DATË NDËRMJET KFW, FRANKFURT AM MAIN (KFW) DHE KESH (HUAMARRËSI DHE MARRËSI) PËR SHUMË DERI NË 43 900 000

Me anë të marrëveshjes datë (Marrëveshje huaje dhe financiare) KfW merr përsipër t'i japë KESH-it një kontribut financiar dhe një hua që nuk e kalon

- | | |
|--------------------------|--------------------------|
| a) kontributin financiar | 5 320 000 euro |
| b) huaja | deri në 38 580 000 euro, |

me kusht që Garantuesi të japë një garanci për detyrimet e pagesave të KESH-IT sipas Marrëveshjeje Financiare dhe huasë të thënë si më poshtë:

Neni 1 Miratimi

Garantuesi, këtu e më poshtë, pranon të gjitha kushtet e Marrëveshjes financiare dhe huasë dhe i garanton të gjitha lejet që mund të jenë të nevojshme për zbatimin e Marrëveshjes së huasë dhe financiare.

Neni 2 Garancia e pagesës

2.1 Akti i dorëheqjes i të gjitha kundërshtimeve dhe mbrojtjes për Marrëveshjen financiare dhe të huasë, Garantuesi, këtu e më poshtë, i jep garancinë e pavarur dhe të parevokueshme KfW-së për kryerjen e pagesave për të gjitha detyrimet e pagesave sipas Marrëveshjes financiare dhe të huasë.

2.2 Në vazhdim, Garantuesi do të bëjë të gjitha pagesat nga KESH-i sipas Marrëveshjes financiare dhe të huasë pa vonesë sipas kërkesës së KfW-së edhe kur këto pagesa nga KESH-i nuk janë bërë në kohë. Detyrimet e pagesës së Garantuesit nuk do të varen në njoftimin e parë të dhënë nga KfW-ja ose të kërkojë pagesa nga KESH-i ose që KfW-ja të ndërmarrë veprime ose hapa të tjera kundrejt KESH-it ose kur KfW provon se KESH-i nuk plotëson detyrimet.

2.3 Garantuesi do të bëjë të gjitha pagesat në euro në nr.31. 19354053 në Frankfurt me referencë përkatëse, asnjë kompensim për kundrejt pretendimeve për pagesa të tilla nuk lejohen.

Neni 9

Ndonjë ose të gjitha shënimet dhe deklaratat e paraqitura nga palët dhe Gjykata e Arbitrazhit në lidhje me veprimet arbitrazhe do të jenë të shkruara. Shënime dhe deklarata të tilla do të merren kur ato mbërrin në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese korresponduese ose në një adresë tjetër të tillë të palës kontraktuese korresponduese, siç shënohet për palën tjetër kontraktuese.

Për KfW:
KfW
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Republika Federale e Gjermanisë
Fax: +49697431-2944

Për Garantuesin:
Ministria e Financave
Bulevardi: “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë, Shqipëri

Për Huamarrësin:
Korporata Elektroenergjetike Shqiptare Sh.a.
Blloku “Vasil Shanto”
Tiranë, Shqipëri

E bërë në 3 origjinalë në gjuhën angleze

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI:

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004

TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004

Doli nga shtypi më 15.6.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi: 150 lekë